



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*

#### **PROCESVERBAL**

Tiranë, më 13.11.2023, ora 13:00

#### **Drejton mbledhjen:**

**Evis Kushi – nënkryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Diskutimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024” me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për arsimin profesional.

2. Seancë dëgjimore me Qendrën Kombëtare të Kinematografisë për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”.

3. Seancë dëgjimore me drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë për Media dhe Informim, zotin Alteo Hysi, për diskutimin në parim të projektligjit "Për buxhetin e vitit 2024".

4. Diskutimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024” me ministren e Kulturës, zonjën Elva Margariti.

#### **Marrin pjesë:**

Evis Kushi, Lindita Buxheli, Petro Koçi, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Ilir Topi, Ilir Metaj, Blerina Gjylameti, Florenc Spaho, Dasantila Tahiraj, Enslemvera Zake, Meri Markiçi, Ina Zhupa, Eralda Bano, Merita Baku, Kastriot Piroli, Orjela Nebijaj dhe Ismet Beqiraj (zëvendësues).

#### **Mungojnë:**

Flutura Aça, Agron Gjekmarkaj dhe Andia Ulliri.

#### **Të ftuar:**

Olta Manjani – zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë,

Albin Gega – drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Punësimit dhe Arsimit Profesional në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë,

Klevis Hysa – drejtor i AKPA-së në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë,  
Ejvis Gishti – drejtoreshë e AKAFPK-së në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë,  
Gentian Opre – drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e  
Financave dhe Ekonomisë.

## HAPET MBLEDHJA

**Evis Kushi** – Përshëndetje, të nderuar kolegë,

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Më lejoni që në fillim t'ju njoftoj se ditën e djeshme deputetët e mazhorancës kanë kërkuar që kjo mbledhje të zhvillohet *online*, për shkak të situatës së bllokimit nga deputetët e opozitës, bazuar në vendimin e Konferencës së Kryetarëve. Kështu, bazuar në nenin 32, pika 2, të Rregullores së Kuvendit deputetët e mazhorancës janë më shumë sesa një e katërta e deputetëve të komisionit, kështu që kjo mbledhje po zhvillohet *online*.

Gjithashtu, bazuar në nenin 23, pika 2, të Rregullores, në mungesë të kryetares, mbledhja drejtohet nga zëvendëskryetarja.

Fillojmë një herë verifikimin e kuorumit, pastaj ju njoftoj rendin e ditës.

Atëherë, të pranishëm në këtë mbledhje janë: zoti Petro Koçi, zonja Merita Baku, zonja Teuta Rama, zonja Eralda Tase, zoti Ilir Metaj, zoti Eduard Ndreca, zoti Ismet Beqiraj, zonja Lindita Buxheli, zoti Ilir Topi, zonja Dasantila Tahiraj, zonja Meri Markiçi dhe zonja Enslemvera Zake.

Jemi më shumë se 50% e anëtarëve të komisionit, kuorumi është i plotë, prandaj fillojmë nga puna. Të konfirmojmë edhe një herë dakordësinë tuaj për ta zhvilluar këtë mbledhje *online*. A jeni dakord, shumica e deputetëve? Dakord!

Faleminderit!

Sot në rendin e ditës kemi dy mbledhje. Në mbledhjen e parë kemi të ftuar: zonjën Olta Manjani, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë, për të diskutuar në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2024”, më pas kemi seancën dëgjimore me Qendrën Kombëtare të Kinematografisë për të diskutuar në parim projektligjin për buxhetin, pastaj kemi seancën dëgjimore me Agjencinë për Medien dhe Informimin, përsëri për buxhetin e vitit 2024.

Ndërkohë, në orën 15:00, do të kemi një mbledhje të dytë: diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024” me ministren e Kulturës, zonjën Elva Margariti.

Fillojmë me mbledhjen e parë. Të ftuar kemi zëvendësministren, zonjën Olta Manjani; bashkë me të janë edhe zoti Klevis Hysa, drejtor i AKPA-së; zonja Ejvis Gishti, drejtore e AKAFPK-së; zoti Albin Gega, drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Punësimit dhe Arsimit Profesional, si dhe zotin Gentian Opre, drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Fjalën ia japim zonjës Olta Manjani për të prezantuar projektbuxhetin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për sa i përket arsimit profesional; më pas kemi seancën e pyetjeve dhe diskutimeve nga kolegët e komisionit.

Zonja Manjani, fjala për ju!

**Olta Manjani** – Përshëndetje!

Faleminderit, zonja nënkryetare e komisionit!

Të nderuar deputetë!

Buxheti për vitin 2024 mban parasysh disa faktorë, disa tregues, fillimisht: ruajtjen e normës së rritjes ekonomike, ofrimin e një mbrojtje sa më të gjerë sociale për të gjitha shtresat në nevojë, si dhe ritmet e rritjes së punësimit, pra ruajtjen e punësimit për të gjitha shtresat.

Më konkretisht, fillojmë me buxhetin për arsimin profesional dhe punësimin. Mund të them që qeveria shqiptare ka miratuar Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, e cila mbulon periudhën 2023 – 2030. Vizioni i kësaj qeverie është punësim cilësor dhe aftësimi afatgjatë, gjatë gjithë jetës, për të gjithë. Objektivi kryesor i kësaj strategjie dhe i planit të saj të veprimit është që, nëpërmjet zhvillimit të aftësive, të bëjë një lidhje sa më të mirë të kërkesës me ofertën në tregun e punës, ndërkohë të mundësojë punësim të denjë për gratë dhe burrat nëpërmjet zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse të tregut të punës. Arsimi profesional ofrohet nga 29 ofrues të këtij arsimi. Këto institucione ofrojnë 26 drejtime mësimore; 87 profile profesionale. Në total numri i nxënësve në arsimin profesional për vitin 2023-2024 është rreth 14 500 nxënës, nga të cilët 2 250 janë vajza. Trendi i regjistrimeve vijon të jetë konstant në vitet e fundit. Numri i nxënësve që ndjekin arsimin profesional kundrejt totalit të nxënësve që ndjekin arsimin e mesëm nga 13%-14%, që ishte në vitin 2013, në rreth 17,7% në vitin 2023.

Prioritetet për periudhën afatmesme 2024-2026 lidhen me modernizimin e infrastrukturës së ofruesve publikë të AFP-së, në përputhje me parimet e ekonomisë së gjelbër dhe transformimit digjital; konsolidimin e kontekstit ligjor dhe institucional për një model të alokimit dhe disbursimit të buxhetit për ofruesit publikë të AFP-së; riorganizimin e rrjetit të ofruesve publikë të AFP-së në kontekstin e zhvillimit të ekosistemit të ofertës së AFP-së; përditësimin e Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale në përputhje me kërkesat për aftësitë dhe profesionet e të ardhmes; promovimin dhe nxitjen e pjesëmarrjes së grupeve të veçanta në AFP, kryesisht të përqendruar te grupet vulnerabël vajzat, personat me aftësi të kufizuara, romët dhe egjiptianët; zbatimin e plotë të procesit të akreditimit për të

gjithë ofruesit publikë të AFP-së, si dhe ofruesit privatë që ofrojnë kualifikime profesionale të niveleve 2 deri 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, bazuar në standardet dhe kriteret e cilësisë sipas modelit të akreditimit; zhvillimin e qasjes dhe modelit të inspektimit në AFP, të harmonizuar me kornizën e garantimit dhe zhvillimit të cilësisë. Do të kemi një fokus të shtuar në garantimin e cilësinë në arsimin profesional; konsolidimin e sistemit të kualifikimit fillestar dhe zhvillimit të vazhduar profesional të mësimdhënësve për të përmirësuar aftësitë teknike, profesionale dhe në shërbim të tranzicionit të gjelbër dhe digjital, në shërbim të mësimdhënies cilësore; zhvillimin dhe zbatimin e mekanizmit të garantimit të cilësisë të ofruesve në zhvillimin e vazhduar profesional për mësimdhënësit e kulturës profesionale; angazhimin e sektorit privat në Këshilli Kombëtar të AFP-së për të lehtësuar kontributin aktiv të komunitetit të biznesit dhe partnerëve socialë në reformën e AFP-së (biznesi ka një rol shumë të ndjeshëm, të theksuar, i cili është marrë parasysh edhe në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim); vlerësimin e nevojave të individëve të rritur për të nxënë gjatë gjithë jetës, për t'i afruar në tregun e punës; akreditimin e ofruesve të njohjes së të nxënësve të mëparshëm; zbatimin e sistemit të njohjes së të nxënësve të mëparshëm, joformal dhe informal; monitorimin dhe vlerësimin e sistemit të njohjes së të nxënësve, me qëllim përmirësimin e tij; zhvillimin dhe operacionalizimin e autonomisë financiare të ofruesve të AFP-së; krijimin e qasjes së ofrimit të AFP-së me kohë të pjesshme dhe zbatimin e ofertës së AFP-së në formë të kombinuar.

Reforma për arsimin dhe formimin profesional është e fokusuar në garantimin e cilësisë, duke siguruar parimet thelbësore të gjithëpërfshirjes dhe lidhjen me tregun e punës. Investimi në AFP është ndër investimet më eficiente, me impakt të sigurt dhe të drejtpërdrejtë në zhvillimin e biznesit dhe rritjen ekonomike të vendit, pasi u përgjigjet mungesave për punonjës të kualifikuar, nxit produktivitetin dhe fitimet e kompanive, rigjallëron sektorët ekonomikë në rënie për shkak të mungesave në aftësi dhe nxit investimet e huaja në vend.

Të dhënat e INSTAT-it, referuar anketës së forcave të punës, tregojnë se shkalla e punësimit, sipas nivelit arsimor, është më e lartë për personat me arsim të mesëm profesional. Shkalla e punësimit të personave me arsim të mesëm profesional është 68,3%, krahasuar me 53% për personat me arsim të mesëm të përgjithshëm. Kjo nënkupton që shanset e punësimit për personat me arsim të mesëm profesional janë rreth 15,3% më të larta, krahasuar me ata që përfundojnë gjimnazin. Vitet e fundit është rritur kërkesa për regjistrime në shkollat e arsimit të mesëm profesional si pasojë edhe e përmirësimit të imazhit të AFP-së.

Digjitalizimi është bërë një element i rëndësishëm i tregut të punës dhe ofruesit e AFP-së po përshtaten që të përdorin avantazhet e tij për të ofruar mënyra të reja të të mësuarit dhe mësimdhënies moderne. Në bashkëpunim me donatorët të ndryshëm po punohet si në drejtim të pajisjes me infrastrukturën e nevojshme dhe logjistikën, por edhe për rritjen e kapacitetit të burimeve njerëzore për shfrytëzimin e avantazheve të digjitalizimit në zhvillimin e procesit mësimor. Nevojat në këtë fushë janë të konsiderueshme dhe situata e COVID-it 2019 vuri në dukje se duhet investuar me përparësi në këtë drejtim si në aspektin e pajisjes me infrastrukturë e logjistikë, ashtu edhe në trajnimin e vazhduar të mësuesve.

Përmes buxhetit të shtetit dhe donatorëve janë bërë investime të konsiderueshme në infrastrukturën e ofruesve të AFP-së, si në aspektin e ndërtesave të reja moderne dhe laboratorëve të praktikave profesionale. Tashmë, pothuajse të gjitha shkollat kanë pajisje të përshtatshme për zhvillimin e të nxënësve praktik dhe teorik. Ndërkohë, po vijon puna për optimizimin e rrjetit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional për t'u pozicionuar në treg si një ofertë arsimore cilësore në përgjigje të nevojave të tregut të punës dhe të shoqërisë në tërësi.

Projektbuxheti për vitin 2024 në lidhje me programin e arsimit të mesëm profesional synon të përmbushë qëllimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim dhe planin e saj të veprimit; të identifikojë dhe të hartojë politikat e duhura për punësimin, arsimin dhe formimin profesional, në mënyrë që të krijojë vende pune dhe mundësi cilësore për punësim dhe aftësim gjatë gjithë ciklit të jetës, pra jo thjesht në ciklin fillestar.

Programi synon zhvillimin e një sistemi të arsimit dhe formimit profesional, i cili garanton arsim, formim profesional cilësor dhe gjithëpërfshirës nëpërmjet sigurimit të një procesi mësimor cilësor dhe me kushte optimale të të nxënësve teorik dhe praktik për t'i pajisur nxënësit me kompetencat e duhura; ndërtimin, rikonstruksionin dhe pajisjen me laboratorë, makineri të shkollave dhe reparteve të praktikave profesionale, si një nga prioritetet dhe në programin e qeverisë “Shqipëria 2030” për arsimin profesional”; rishikimin e programeve ekzistuese dhe hartimin e programeve të reja në përputhje me parimet e barazisë gjinore dhe gjithëpërfshirjes, në zbatim të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve; zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve, si një nga shtyllat kryesore të sigurimit të cilësisë në arsimin profesional; vijimin e implementimit të akreditimit të ofruesve të AFP-së; funksionimin e komiteteve sektoriale (të krijuara deri më tani janë dy: komitetet sektoriale në teknologjinë e informacionit dhe në sektorin e mikpritjes dhe të turizmit), si dhe vijimin e punës për krijimin e komiteteve të tjera në vlim, që janë shumë të rëndësishme për të marrë

një *feedback* nga tregu në lidhje me aftësitë që kërkon tregu, si mund t'i përgjigjemi ne për pajisjen e forcës punëtore me këto aftësi dhe fillimin e funksionimit të strukturës së inspektimit të arsimit profesional.

Për vitin 2024 në tremat e treguesve të synuar mund të përmendim: rritjen e aksesit në arsimin e mesëm profesional, duke synuar që në vitin 2024 të tërhiqen 18,2% e nxënësve që ndjekin ciklin e arsimit të mesëm, nga 17,7% në vitin 2023; rritjen e përqindjes së të punësuarve pas diplomimit në shkollat e mesme profesionale në 60% të totalit që mbarojnë studimet në vitin 2024, krahasuar me 57,5% që ishte në vitin 2023; rritjen e numrit të nxënësve që vijnë nga zonat rurale, të cilët ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale, nga 43% e totalit në vitin 2023, në 45% e totalit në vitin 2024; rritjen e numrit të nxënësve romë dhe egjiptianë që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale nga 670 nxënës në vitin 2023, në 710 nxënës në vitin 2024. Fondet e planifikuara në buxhetin e vitit 2024 për arsimin e mesëm profesional janë 3 miliardë e 530 milionë e 469 mijë lekë.

Në materialin që ju kemi dërguar, ka edhe një shpërndarje të detajuar të alokimit të këtij fondi në zëra të caktuar.

Në shpenzimet korrente buxheti është planifikuar me 722, 120 lekë, fond, i cili është i mjaftueshëm për të zhvilluar politikat ekzistuese dhe politikat e reja në fushën e arsimit profesional. Është planifikuar buxheti për bursat e nxënësve në masën 277 milionë lekë, të cilët ndjekin arsimin profesional. Për të ngushtuar hendekun gjinor në arsimin profesional për vitin 2024, krahas rishikimit të kurrikulave me bazë gjinore, në vendimin e Këshillit të Ministrave për bursat tashmë do të stimulohen me bursë edhe nxënëset vajzat që ndjekin drejtimet mësimore tipike për djemtë me bursa 100%, ndërkohë ofrohen edhe bursa 50% për të gjitha vajzat që ndjekin arsimin profesional, pavarësisht orientimit apo degës që ndjekin. Shpenzimet korrente për mallra dhe shërbime do të përdoren për praktikat profesionale të nxënësve dhe janë planifikuar shpenzime të mjaftueshme për zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

Në zërin "shpenzime kapitale" janë planifikuar 548,5 milionë lekë shpenzime, të cilat do investohen në: ndërtimin dhe rikonstruksionin e shkollave dhe bazave prodhuese; pajisjen e reparteve të praktikës profesionale me pajisje dhe makineri, si dhe për blerje pajisjesh për laboratorët e lëndëve të përgjithshme. Konkretisht, për të përmirësuar kushtet dhe ambientet në të cilat zhvillohet mësimi teorik dhe praktik. Me financim të buxhetit të shtetit janë parashikuar që gjatë vitit 2024 të rikonstruktohen shkollat e mëposhtme: rikonstruksion, ndërtim shtesë në shkollë e mesme profesionale "Hysen Çela", në Durrës; rikonstruksion i

shkollës “Kolin Gjoka” në Lezhë; rikonstruksion, ndërtim i repartit të përpunimi të drurit në shkollën "Karl Gega" në Tiranë; rikonstruksion i Shkollës Mekanike në Lushnjë; rikonstruksione të pjesshme në shkollat profesionale të Kamzës dhe atyre profesionale të “Shërbimeve” në Korçë.

Një komponent i rëndësishëm i zhvillimit të mësimnxënies dhe mësimdhënies në AFP-të është edhe infrastruktura bashkëkohore e reparteve të praktikave profesionale. Për këtë qëllim janë planifikuar fonde për blerje laboratorësh, për blerje të pajisjeve dhe makinerive. Konkretisht: laboratorë dhe pajisje për digjitalizimin, kompjuterë dhe laboratorë të IT-së; pajisje dhe makineri për repartet e praktikave profesionale.

Fondet e planifikuara për vitin 2024 do të investohen edhe në modernizimin e kuadrit ligjor ekzistues që rregullon sistemin e AKP-së, si dhe aspekte që kanë të bëjnë me arsimin dhe formimin profesional, hartimin e skelet-kurrikulave, materialeve mësimore, trajtimin e mësuesve, që është një element shumë i rëndësishëm; rishikimin e programeve ekzistuese dhe hartimin e programeve të reja në përputhje me parimet e barazisë gjinore dhe gjithëpërfshirjes, në zbatim të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve; hartimin e standardeve të profesioneve dhe kualifikimeve sipas niveleve të KSHK-së; zhvillimin e kompetencave të mësuesve dhe instruktoreve të AFP-së në përshtatje me zhvillimet e reja teknologjike, që, për hir të së vërtetës, vitet e fundit janë shumë të shpejta; forcimin e lidhjeve midis të nxënit dhe punës, dhe vijimin e implementimit të akreditimit të ofruesve të AFP-së.

Në vijim do të doja të theksoja se ka një rritje të buxhetit për arsimin profesional ndër vite. Nëse flasim për vitin 2017, ky buxhet ishte rreth 2, 2 miliard lekë; në vitin 2018 ishte 2,4 miliard lekë; në vitin 2019 ishte 2,7 miliard lekë; arrijmë në vitin 2023 me 3, 3 miliard lekë dhe në vitin 2024 me 3, 53 miliard lekë.

Pra, në vite vërehet që ka një rritje të interesit të qeverisë, që është materializuar edhe në rritjen e buxhetit për arsimin profesional, i cili, për hir të vërtetës, është një mënyrë që nxënësit të dalin shpejt në tregun e punës, duke u ofruar atyre paga konkurruese, si dhe një investim minimal në bankat e shkollës, pasi, me mbarimin e një arsimit profesional dhe marrjen e një zanati, studentët që diplomohen në shkollat e arsimit të profesional janë të gatshëm të integrohen shpejt në tregun e punës.

Ju falënderoj për vëmendjen dhe mbetemi të hapur për pyetje pas relatorit.

Faleminderit!



**Evis Kushi** – Zonja Manjani, shumë faleminderit për këtë prezantim, gjithashtu edhe për materialin, për këtë raport të zgjeruar dhe të detajuar të projektbuxhetit sa i takon arsimit profesional për vitin 2024!

Para se t'ua kaloj fjalën kolegëve për pyetje apo diskutime, dua t'ju njoftoj se në mbledhje na janë bashkuar zonja Blerina Gjylameti, zonja Oriela Nebijaj dhe zoti Florenc Spaho.

Atëherë, po i filloj unë pyetjet sa të përgatiten kolegët për pyetje ose diskutime.

Një nga iniciativat tuaja të përbashkëta, që e kam vlerësuar gjatë mbledhjes që zhvilluam me ministren e Arsimit dhe Sportit, zonjën Manastirliu, është fushata “Zgjidh zanatin”, një fushatë që u prit shumë mirë, që ka si qëllim promovimin e vlerave të arsimit profesional, si dhe nxitjen e të rinjve dhe të rejave në zgjedhjen e arsimit profesional, sidomos në këtë kohë, kur nevojat për teknikë dhe profesionistë të fushave të ndryshme janë gjithnjë në rritje, si dhe kërkesat në tregun e punës janë gjithnjë e më të mëdha.

Kemi lënë një afat, deri në fund të muajit dhjetor, që ata nxënës që tashmë janë regjistruar në arsimin e përgjithshëm, nëse kanë dëshirë, në bazë të kësaj fushate dhe të komunikimit që ju bëni me mësuesit dhe nxënësit, por edhe me prindërit, të mund të çregjistrohen dhe të regjistrohen në arsimin profesional. Si po ecën kjo fushatë? Nëse keni statistika deri tani, a keni pritshmëri për këtë vit? Sigurisht, rezultatet mund të mos i shohim menjëherë, por vitin e ardhshëm do të kemi më shumë. Gjithsesi doja të dija nga ju: si po ecën kjo fushatë dhe a keni pritshmëri të mira?

Faleminderit!

**Olta Manjani** – Zonja Kushi, fillimisht dua t'ju falënderoj juve për të gjithë mbështetjen që kemi gjetur në Ministrinë e Arsimit në kohën kur ju ishit ministre! Ju dini që kjo është një nismë, të cilën e kemi ndërmarrë prej disa kohësh, por që u finalizua me bashkëfirmosjen e urdhrin të dy ministrave, për të mundësuar lëvizjen horizontale të nxënësve nga gjimnazi në arsimin profesional, duke u lënë një periudhë kohore 3-mujore, një periudhë e cila do t'i nxisë nxënësit për këtë lëvizje horizontale, por, në anën tjetër, nuk i pengon ata të kapin ritmin në arsimin profesional, pasi bëhet fjalë për një periudhë kohore relativisht të shkurtër dhe gjatë kësaj periudhe bëhen kryesisht lëndët e përgjithshme.

Një nga problemet që ne kishim për implementimin e kësaj nisme ishte të siguroheshim që nxënësit të arrinin të merrnin lëndët e përgjithshme në të dyja këto sisteme dhe me kalimin në arsimin profesional të mos humbnin nga lëndët e profesionit.

Ne shpresojmë që kjo nismë të japë frytet e duhura, kemi vënë re rezultatet e para të kësaj nisme, pasi kemi konstatuar që ka reregjistrime, pra çregjistrime nga gjimnazi dhe regjistrim në arsimin profesional. Nuk do të doja të gaboja me shifrën, pasi nuk e kam shifrën e fundit, nuk e di nëse drejtori i AKPA-s mund të na japë ndonjë shifër. Shifra e fundit që kam është ajo e para disa ditëve dhe, duke qenë së është një proces që ka vijuar gjatë fundit të javës së kaluar, por edhe gjatë ditës së sotme, nuk do të doja të gaboja me shifrat. Megjithatë, siç e thamë, është vetëm fillimi i kësaj fushate dhe këtë vit ne nuk presim të ketë zhvendosje masive, pasi fushata është akoma *on going*, pra ne akoma po bëjmë vizita në shkollat profesionale ndërkohë që Ministria e Arsimit është e fokusuar te gjimnazet e përgjithshme. Por ajo që duam të arrijmë në vitin e parë është rritja e ndërgjegjësimit, pra që studentët ta dinë se kanë një zgjidhje tjetër krahas arsimit të mesëm të përgjithshëm. Sigurisht, kjo nuk është një fushatë vetëm për nxënësit, por edhe për prindërit, duke qenë se vendimmarrja në moshë kaq të hershme orientohet edhe nga prindërit.

Nëpërmjet kësaj fushate ne duam të apelojmë të gjithë prindërit, që kanë ndikim në vendimmarrjen e fëmijëve të tyre, për t'i regjistruar ata në shkollat e arsimit profesional, pasi është një arsim që garanton një cilësi shumë të lartë. Shkollat janë të investuara, të rikonstruara, kanë pajisje moderne dhe, krahas garantimit të cilësisë, sigurohet që të gjëjë punë që në bankat e shkollës për rreth 60% e nxënësve që studiojnë në arsimin profesional, sepse ata kryejnë praktika profesionale jo vetëm në ambientet e shkollës, por edhe në ato të biznesit.

Të gjitha shkollat profesionale kanë si drejtues të bordit të tyre një përfaqësues nga biznesi, gjë që ka garantuar në vijimësi një marrëdhënie shumë të ngushtë me biznesin jo vetëm në hallkën e fundit, pra në punësimin e studentëve, por edhe në përfshirjen e bizneseve në hartimin e kurrikulave dhe në analizën e nevojave të tregut për aftësi. Pra, arsimi profesional realisht garanton një zgjedhje optimale për të gjithë ata nxënës që nuk duan atë investohen në karrierën akademike, por duan të marrin një profesion dhe të integrohen në mënyrë të shpejtë në tregun e punës.

**Evis Kushi** – Faleminderit, zonja Manjani!

A kanë ndonjë pyetje kolegët?

Fjala për zonjën Tahiraj, më pas do ta marrin fjalën zonjat Buxheli, Markiçi dhe zoti Beqiraj.

**Dasantila Tahiraj** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Në fakt, zëvendësministrja bëri një panoramë të strategjisë për zhvillimin e arsimit profesional. Ashtu siç e theksoi zonja Kushi, “Zgjidh zanatin” është një nga iniciativat më gjithëpërfshirëse dhe që ka lënë gjurmë te çdo prind që do që fëmija e tij të ketë një zanat që në fillesa, pra që në shkollën e mesme.

Pyetja ime lidhet me një nga masat prioritare që ju kemi paraqitur këtu, pra krijimi i sistemit të inteligjencës së aftësive, që japin sinjale të rregullta për zhvillimet e tregut të punës dhe të AKPA-së. Kjo është një nga masat prioritare të paraqitura nga ju për zhvillimin e strategjive të qeverisë për arsimin profesional. Si perceptohet kjo masë prioritare dhe si do të zhvillohet ajo në territor?

Faleminderit!

**Evis Kushi** – Atëherë, zonja Manjani, po i grupojmë të gjitha pyetjet, pastaj mund të vijoni me përgjigjet e tyre.

Fjala për zonjën Buxheli, më pas për zonjën Markiçi dhe zotin Beqiraj.

**Lindita Buxheli** – Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, doja ta falënderoja zëvendësministren për investimin në rikonstrukcionin e Shkollës Mekanike Bujqësore, Lushnjë, një shkollë me mjaft tradita në arsimin profesional! Ndërkohë, financimi prej 3,4 miliardë lekësh, që bëhet për arsimin profesional, tregon edhe vëmendjen e shtuar në drejtim të këtij arsimi.

Pyetja ime është konkrete: duke qenë se infrastruktura është e domosdoshme në Shkollën Mekanike, po kështu investimi do ta zhvillojë akoma më tej, a është mundur hapja e një dege agronomie, sepse, siç dihet, Lushnja është epiqendra e bujqësisë? Po ju jap vetëm një fakt, zonja zëvendësministre: 670 hektarë sera kultivohen vetëm në Bashkinë e Lushnjes dhe Bashkinë e Divjakës, ku, siç dihet, 20% e prodhimit në këto serra bëhet pikërisht nga Lushnja dhe Divjaka. Ndaj, hapja e një dege të mesme agronomi do të jetë gjithmonë në funksion të këtij sektori mjaft të rëndësishëm.

Faleminderit!

**Evis Kushi** – Po, zonja Markiçi.

Ju lutem, fjala është për ju.

**Meri Markiçi** – Faleminderit!

Faleminderit, zonja kryesuese e komisionit!

Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Falënderoj gjithë të ftuarit dhe kolegët!

Unë kam disa pyetje për zonjën zëvendësministre.

Pyetja e parë: në çfarë faze është procesi i akreditimit të ofruesve publikë apo privatë të AKPA-së, si një proces shumë i rëndësishëm?

Pyetja e dytë: a parashikoni të hapni drejtime të reja apo rishikim të drejtimeve ekzistuese, me qëllim rritjen e cilësisë, që të jenë gjithnjë e më tepër në përputhje me nevojat e tregut të punës që ndryshojnë shumë shpesh?

Pyetja e tretë: në çfarë faze është puna për qendrën multifunktionale të Shkodrës, meqë është një projekt i hershëm? Ju kujtoj kushtet në të cilat punon sot Qendra e Formimit Profesional, Shkodër. Është tejet e nevojshëm krijimi i një qendre të tillë multifunktionale për Shkodrën.

Pyetja e fundit: a keni ju një mekanizëm? Nëse po, si funksionon ky mekanizëm në lidhje me zyrat e punësimit, pra lidhja e shkollave profesionale me zyrat e punësimit, që të ketë sa më shumë bashkëpunim për integrimin e studentëve që dalin nga këto banka për në tregun e punës? Cilat janë hapat e mëtejshëm që do të merren për përmirësimin e këtij mekanizmi për rritjen e të punësuarve që dalin nga shkolla e arsimit të mesëm profesional?

Faleminderit!

**Evis Kushi** – Fjala për zotin Beqiraj.

**Ismet Beqiraj** – Përshëndetje!

Dëgjesa sot me zëvendësministren, zonjën Manjani, për arsimin profesional është shumë e rëndësishme.

Një prej zëvendësministrave të një sektori strategjik të vendit tonë gjatë dëgjesave në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin u shpreh se çdo sektor ekonomik zhvillohet mbi bazën e trinomit: para-punë-specialistë, “specialistë profesionistë të shkollave të mesme dhe të larta”. Gjej rastin të falënderoj përfaqësuesen e ministrisë, sepse arsimit dhe formimi profesional ka pësuar ndryshime në aspektin e krijimit të bazës së të gjithë logjistikës programore, në bazë të kornizës shqiptare të arsimit! Janë përgatitur një sërë kurrikulash të veçanta për profesione. Duke u nisur nga numri i profesioneve të rregulluara në Republikën e Shqipërisë, që i kalon 4225, janë shtuar edhe ca të tjerë, numri i profileve përkatëse, sikurse paraqitet, si i ofertuesve profesionale, ashtu edhe i profileve dhe kërkesave që ka tregu, nuk më duket njëlloj.

A mendoni se ka planifikim edhe në këtë buxhet të veçantë për të rritur jo vetëm rolin e ofertuesve të arsimit profesional, por edhe për të shtuar profilet profesionale, sepse nuk janë vetëm 87 profile në këtë mori të numrit të profesioneve të rregulluara në Republikën e Shqipërisë?

Nga ana tjetër, po të shikojmë trendin e regjistrimeve në shkollat profesionale, nga 13-14%, që kanë qenë më parë, në vitin 2023, që po përfundon tani, numri i nxënësve të regjistruar që kanë mbaruar klasën e nëntë është 17,7% dhe për vitin 2024 parashikohet një rritje e lehtë. Si mund të zgjidhet kërkesa që ka vendi për profesionistë, që është kritike dhe e ethshme?

A mendoni se arsimi dhe formimi profesional duhet të decentralizohet? Në cilin aspekt e kam këtë? Nuk duhet të përqendrohet vetëm në disa qendra, sikurse është sot. Kemi 61 bashki, në të cilat ekziston infrastruktura e shkollave profesionale. Sigurisht, ka amortizim të pjesshëm fizik, por ato mund të rehabilitohen. Ne nuk mund të implementojmë një teknologji të re në industri, edhe këtë që është në funksion, nëse nuk ngremë pothuajse në të gjithë vendin zinxhirin e shkollave profesionale të profesioneve. Pse duhet kjo? Ka shumë mungesa në bujqësi. Një nga detyrimet që ka kjo mazhorancë është përditësimi i tokave bujqësore, sipas ligjit nr. 7051. Bashkitë kanë nevojë për specialistë topografë. Si do të realizohet kjo reformë? Nuk po diskutoj për agronomë, veterinerë, të mesëm dhe të lartë.

Ndaj, unë do të sugjeroja, edhe pse dua një përgjigje nga ju, t'u rikthehem shkollave profesionale mbi bazën e bashkive. Mbi bazën e kërkesave dhe nevojave që ka çdo bashki, përgatiten edhe paketa sociale për të mbështetur, incentivuar dhe nxitur elementët. Nuk duhet të krijojmë edukim të arsimit të lartë dhe të kemi, t'ju them të vërtetën, një inflacion ose mbiarsimim, që është bërë edhe si model kritik. Të gjithë juristë apo ekonomistë do të bëhen? Si do ta zhvillojnë bujqësinë moderne, blegtorinë, zanatet e të gjitha me radhë?

Ju kërkoj ndjesë që po ju marr kohë, por dua t'ju tregoj vetëm një shembull nga historia, edhe pse është e një kohe tjetër, por ama gjërat racionale duhet t'i marrim. Kur filloi ndërtimi i Kombinatit të Përpunimit të Thellë të Naftës në Ballsh, u hap zinxhiri i shkollave të mesme profesionale, shkollave të mesme 2-vjeçare dhe 4-vjeçare, sepse nuk zhvillohej dot ky sektor. Në të njëjtën situatë kritike është edhe sot industria e nxjerrjes dhe e përpunimit të naftës. Ku përgatiten teknologët, sondistët, mekanikët, elektrikiçistët e zanate të tjera? Të gjitha këto duhet të marrin rëndësi. Unë shoh se para ka, buxheti këtë radhë, këtë e them me gojën plot, jo vetëm që realizon objektivat e tij, por bën edhe rialokime në mes të vitit, në përfundim të 3-mujorit të parë, gjë që tregon se ekonomia jonë po rritet me ritme të shpejta.

Fola pak gjatë, sepse vij vetë nga profesionet e rregulluara.

Faleminderit!

**Evis Kushi** – Faleminderit, zoti Beqiraj!

Zonja Manjani, besoj se i keni mbajtur shënim të gjitha pyetjet.

Ju lutem, përgjigjet!

Fjala për ju.

**Olta Manjani** – Faleminderit, për pyetjet!

Do të përpiqem t'i marr pyetjet që u bënë, sipas radhës. Po filloj me pyetjen e zonjës Tahiraj. Sa i takon observatorit të tregut të punës, ai është një platformë që na ndihmon ne të bëjmë vazhdimisht analiza të tregut të punës. Është një platformë, e cila pasurohet vazhdimisht, që do të thotë se filloi me një marrëveshje mirëkuptimi ndërmjet zyrave të punës, pra Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, si dhe të gjithë operatorëve privatë, që bëjnë shpalljen e vendeve të lira të punës në mënyrë që të ketë një darkodësi që të gjitha vendet e lira të shpallura të punës, të cilat anonçoheshin nga këto kompani private të bëheshin edhe në faqen e AKPA-s, në mënyrë që ne të kishim në të njëjtin vend shpallje të të gjitha vendeve të lira të punës. Kjo na ndihmon ne që të marrim një informacion tërësor mbi vendet e lira të shpallura të punës dhe mbi aftësitë që kërkon tregu.

Pra, platforma që po zhvillohet nga Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, e cila siç jua thashë pasurohet vazhdimisht, ndër të tjera ka edhe këto elemente siç është qendërimi i të gjithë informacionit të tregut të punës në mënyrë që të jetë i lehtë jo vetëm për përdoruesit, që në këtë rast janë qoftë punëdhënësit që bëjnë shpalljen e vendeve të lira të punës, qoftë punëkërkuesit, të cilët janë në kërkim të një pune, por do të na ndihmojë edhe ne që të kemi në një vend të qendëruar të gjithë informacionit mbi tregun e punës.

Në lidhje me pyetjen që bëri zonja Buxheli, doja të bëja vetëm një korrigjim të vogël. Në fakt, buxheti nuk është 3,4 miliardë lekë, por është 3,53 miliardë lekë. Ky nuk ka rëndësi, ishte thjesht për saktësim.

Në lidhje me pyetjen që ngriti deputetja për hapjen e një dege ekonomie në Lushnjë, dua ta informoj që ne kemi një degë të mekanikës bujqësore, ndërkohë kemi dy shkolla në afërsi me shkollën profesionale të Lushnjës, shkollat e Fierit dhe e Golemit, të cilat janë shkolla me konvikt dhe që ofrojnë degën e agronomisë.

Këtë po e lidh pak edhe me çështjet që ngriti zoti Beqiraj. I gjithë sistemi i arsimit dhe i formimit profesional po kalon një fazë të thellë reformimi, siç është procesi i optimizmit, ku ne bëjmë fillimisht disa bashkime shkollash. Për shembull, mund t'ju them se në rrethin e Korçës kanë qenë 5 shkolla profesionale me një numër shumë të vogël nxënësish në secilën prej tyre dhe nuk ishte optimale dhe efiçente, qoftë në aspektin e menaxhimit të infrastrukturës, të burimeve njerëzore apo të burimeve financiare mbajtja e këtyre 5 shkollave. Në kuadër të procesit të optimizmit janë bashkuar 3 shkolla në 1 shkollë, që quhet

Shkolla Teknike, ku janë futur degë si IT-ja, mekanika, shërbim mjetesh transporti e të tjera dhe një shkollë tjetër që quhet Shkolla e Shërbimeve, ku janë bashkuar shkollat që ofronin hoteleri-turizëm, veterinari dhe bujqësi.

Sipas studimeve që ka kryer Ministria e Financave në bashkëpunim me donatorët shkollat që ishin të vogla në madhësi ishin, gjithashtu, shkolla të nënkapacituara, pra kanë funksionuar vazhdimisht nën kapacitetin e tyre. Në qoftë se në një shkollë duhet të studionin 200 apo 300 nxënës, po jua jap si shembull, këtu studionin më pak se 100 nxënës. I gjithë qëllimi i procesit të optimizimit është grupimi i tyre në pole të caktuara dhe më pas riorganizimi i të gjitha burimeve infrastrukturore dhe financiare me qëllim rritjen e eficiencës.

Sigurisht, kjo është e rëndësishme për reduktimin e kostove, për përqendrimin e energjive në pole të caktuara, pra ngritja e një poli të hoteleri-turizmit, ngritja e një poli shërbimesh, ngritja e një poli për agrobujqësinë e kështu me radhë.

Do t'i rikthehem sërish kësaj teme në momentin kur t'u jap përgjigje pyetjeve të zotit Beqiraj.

Po vazhdoj me pyetjet që ngriti zonja Markiçi, në lidhje me procesin e akreditimit. Procesi i akreditimit ka filluar që në vitin 2023 dhe aktualisht po ecën mirë. Janë akredituar 5 institucione publike, ndërkohë që ne vazhdimisht i nxisim si institucionet publike, ashtu edhe institucionet private që të aplikojnë në mënyrë që të gjitha institucionet në një moment të jenë të akredituara. Ky është një proces shumë strikt, që kalon nëpër disa faza, por siç jua thashë, aktualisht kemi 5 institucionet e para publike që janë të akredituara.

Sa i takon pyetjes tjetër, ne sigurisht hapim vazhdimisht drejtime të reja, qoftë drejtime të sistemit 2+1+1, qoftë drejtime pas të mesmes. Këtu mund t'ju përmend një drejtim që ka qenë shumë i kërkuar kohët e fundit nga tregu, konsulentë në fushën e pasurive të patundshme, që është një program pas të mesmes. Një tjetër program i kërkuar pas të mesmes është edhe shërbime mjetesh transporti, modë, tekstil, dizajn e të tjera. Pra, ne jemi vazhdimisht duke i pasuruar profilet dhe programet qoftë si në sistemin 2+1+1, që vjen kryesisht me kërkesë të shkollave apo me kërkesë të bizneseve që operojnë në afërsi të shkollave, qoftë edhe të programeve pas së mesmes, ku disa prej tyre janë ato që ju përmenda.

Pyetja tjetër po nga zonja Markiçi, kishte të bënte me ngritjen e qendrës shumëfunktionale të Shkodrës. Përfitoj nga rasti ta informoj se qendra shumëfunktionale e Shkodrës do të ndërtohet pranë shkollës "Arben Broci" dhe është një proces që është në

vijim, sepse, siç jua thashë i gjithë sistemi i arsimit dhe formimit profesional po kalon një fazë reformomi.

Në lidhje me pyetjen për lidhjen e shkollave me zyrat e punës, kjo është realisht një lidhje shumë e ngushtë. Siç jua thashë edhe gjatë fjalës sime kjo vjen natyrshëm, pasi mbi 90% e studentëve që studiojnë në shkollat e arsimit profesional kryejnë praktikat profesionale qoftë në ambientet e shkollës, qoftë në ambientet e biznesit, pra ka një lidhje të ngushtë midis shkollës dhe biznesit, madje çdo shkollë ka atë që quhet njësia zhvillimore. Njësia zhvillimore merret pikërisht me koordinimin e marrëdhënieve midis nxënësve dhe tregut të punës ku një rol të veçantë në këtë bashkëpunim ka edhe zyra e punës.

Referuar rezultateve të analizës së fundit të gjurmimit, e cila është publikuar para 1 jave apo disa ditësh, në mos gaboj, tregon se ka një rritje të numrit të nxënësve që janë të punësuar që gjatë kohës që kryerjes së studimeve. Aktualisht kjo është në masën 60%, pra një masë relativisht e lartë, që do të thotë se pjesa më e madhe e nxënësve gjejnë një punë që në bankat e shkollës çka dëshmon për lidhjen e ngushtë që ka sistemi arsimor profesional me tregun e punës.

Po kaloj te pyetjet që parashtroi zoti Beqiraj. Fillimisht dua ta informoj se ne po bëjmë një SMA. SMA-ja vjen nga anglishtja, *skills meat analysis* ose e thënë në shqip “një analizë e nevojave dhe e tregut të punës për aftësi”. Në këtë kontekst ne kemi shtuar dhe do të shtojmë edhe profile, të cilat në bazë të kësaj analize dalin se janë shumë të kërkuara nga tregu. Pra, drejtimet dhe profilet janë ngritur, janë vazhdimisht në rritje dhe ofrojnë kualifikime të gjëra, duke mbuluar një gamë të gjerë profesionesh.

Ndërkohë, edhe procesi i optimizimit, për të cilin po flisja, do të ndikojë patjetër në diversifikimin e ofertës. Ajo që ka bërë qeveria shqiptare gjatë kësaj kohe është diversifikimi i ofertës edhe në aspektin e përfshirjes së ofruesve privatë, pra ne jemi koshientë që nuk mund të jenë vetëm ofruesit publikë të arsimit dhe të formimit profesional, por ka edhe një gamë të gjerë ofruesish privatë. Për ta mbështetur rritjen e kësaj oferte, gjatë vitit 2023 është aplikuar edhe programi i subvencionit për të gjitha kurset e kodimit, që do thotë se ka pasur një bashkëpunim të ngushtë me institucionet private të arsimit dhe të formimit profesional, të cilët ofrojnë kurse në fushën e Teknologjisë së Informacionit, ku qeveria shqiptare ka subvencionuar në masën 100% kurse për të gjithë punëkërkuarit e papunë të regjistruar pranë zyrave të AKPA-s, Agjencisë së Punësimit, dhe 50% për çdo aplikues tjetër, që janë kryesisht moshat e reja për shkak edhe të profileve që ofrohen në këto kurse të Teknologjisë së Informacionit dhe 50% për aplikuesit e tjerë.



Ndërkohë, sa i takon decentralizimit, ofruesit tanë operojnë si shkollë ndërkombëtare, ndaj edhe po intensifikohen përpjekjet për ngritjen dhe rikonstruksionin e konvikteve. Pra, nuk është efiçiente, qoftë në termat e kostove qoftë në termat e menaxhimit të burimeve njerëzore apo të burimeve infrastrukturore hapja e një shkolle profesionale në çdo bashki, por nga ana tjetër bashkia ka në menaxhimin e saj konviktet e këtyre shkollave. Ajo që ne po përpiqemi të bëjmë është që ta kthejmë këtë në një projekt social në mënyrë që, unë e thashë edhe gjatë fjalës sime, të rrisim gjithëpërfshirjen dhe të tërheqim drejt arsimit profesional edhe ata nxënës që jetojnë në zonat rurale dhe nuk kanë mundësi që ta ndjekin arsimin profesional pranë qendrës së tyre të banimit t'u ofrohet mundësia që ata të akomodohen në konvikte dhe në këtë mënyrë të zgjidhet edhe çështja e gjithëpërfshirjes.

Për shembull, në shkollat e Tiranës, ku kemi 5 shkolla profesionale, ka nxënës që vijnë nga e gjithë Shqipëria apo në shkollën e Cërrikut, ku ishim për vizitë para disa kohësh, ka nxënës që vijnë edhe nga Gjirokastra. Pra, ofrimi i një konvikti, sigurisht do të tërheqë një numër të madh nxënësish nga rrethet dhe pjesa më e madhe e shkollave profesionale kanë një konvikt. Megjithatë, vëmendja jonë gjatë këtij viti akademik dhe më tej do të jetë në rindërtimin dhe rikonstruksionin e ambienteve të konvikteve.

**Evis Kushi** – Faleminderit, zonja Manjani, për të gjitha shpjegimet dhe përgjigjet e pyetjeve!

Shoh në ekran që na është bashkuar në mbledhje edhe zonja Ina Zhupa, e cila ka kërkuar fjalën.

Po ashtu, fjalën e ka kërkuar edhe zoti Beqiraj, për të diskutuar diçka në lidhje me përgjigjet e zonjës Manjani.

Fjalën e ka zonja Ina Zhupa.

Më pas fjalën e ka zoti Beqiraj.

**Ina Zhupa** – A dëgjohem?

**Evis Kushi** – Po, dëgjoheni.

**Ina Zhupa** – Zonja Kushi, ndërhyrja ime është vetëm për t'ju thënë se duhet të hiqni dorë nga praktikat e mbledhjeve *online*, virtuale, dhe t'i ktheheni kushtetutshmërisë dhe Rregullores së Kuvendit që të kemi mundësi që buxhetin ta shqyrtojmë duke i dëgjuar përfaqësuesit *live* dhe normalisht. Ju jeni duke e shkelur Kushtetutën dhe Rregulloren, duke u hequr të drejtat deputetëve opozitarë, duke mos lejuar komisionet hetimore, duke mos lejuar përfaqësimin në Komisionin e Reformës Zgjedhore dhe duke diktuar ju se kush do të jetë opozita në vend.

Do t'ju lutesha që t'i ktheheni normalitetit dhe zbatimit të Kushtetutës!

Ju e keni humbur lidhjen me realitetin duke kaluar në virtualitet, por kjo nuk ju nderon, ju si Komision i Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik, njerëz që mund ta ngrini zërin brenda grupit tuaj parlamentar, për të kërkuar që të kthehet në normalitet.

Kjo ishte ajo që unë kisha.

**Evis Kushi** – Zonja Zhupa, faleminderit për ndërhyrjen tuaj!

Unë besoj se kjo ndërhyrje nuk vlen për ne, deputetët e mazhorancës, sepse ne kemi qenë gjithmonë aty, edhe javën e kaluar, për t'i zhvilluar mbledhjet me prezencë fizike, si gjithmonë dhe normalisht në sallën ku i zhvillojmë mbledhjet, por ishin pikërisht kolegët tuaj, madje edhe burra, edhe gra, të cilët kishin bllokuar derën dhe nuk na lejonin të futeshim brenda për të zhvilluar normalisht mbledhjet e komisionit. Ju jeni dëshmitare, sepse pamjet janë transmetuar; ju vetë personalisht nuk keni qenë, por kolegët tuaj kanë qenë ata që na kanë penguar. Kështu që këtë thirrje mund t'ua bëni kolegëve tuaj, të deklaroni që ju do t'i lejoni normalisht mbledhjet dhe patjetër ne jemi të parët të interesuar për t'i zhvilluar normalisht mbledhjet dhe për ta diskutuar projektbuxhetin ashtu siç e meritojnë qytetarët. Ky është projektligji më i rëndësishëm në Kuvendin e Shqipërisë. Sigurisht, seancat duhet të bëhen normale, me prezencën e të gjithë deputetëve për t'i sqaruar, për transparencë, të gjitha detajet e këtij projektbuxheti.

Unë do t'ju lutesha shumë juve dhe kolegëve tuaj që të mos na bllokojnë më as në seancat plenare dhe as në seancat e komisionit, në mënyrë që puna të vijojë normalisht.

Unë ju falënderoj për ndërhyrjen, por këtë thirrje duhet t'ua bëni kolegëve tuaj!

Fjalën e ka zoti Beqiraj.

**Ismet Beqiraj** – Lidhur me përgjigjen e pyetjes që kishte të bënte me decentralizimin, zonja Zëvendësministre, është gati një dekadë e tërë, ku, sipas shifrave që vetë ju i keni hartuar dhe përpiluar, numri i të regjistruarve në arsimin profesional në vitin 2013 ishte 12,4% dhe në vitin 2023 mendohet të shkojë 17,7%. Pra, për 10 vjet trendi është rritur vetëm 3,3%.

Si ta quajmë këtë? Kjo formë që ju zgjidhni, në mënyrë të centralizuar, që të gjitha shkollat profesionale t'i përqendroni në bashkitë e qendrës, bie fjala të qarkut Fier ose në Tiranë, edhe për 10 vjet të tjera trendi do të shkojë 5%. Ky është plotësimi i nevojave të tregut me specialistë?! Jo. Duke qenë i përqendruar në mënyrë të tillë, nuk bëhet edhe marketing për regjistrimin në shkollat profesionale, sepse bashkitë e marrin përgjegjësinë direkt, qoftë edhe me bursa, ato incentivojnë me punësime të ndryshme edhe në sektorin

privat, edhe në sektorin publik. Është vetë shifra e tillë, mos ngulni këmbë kot, sepse është një debat që unë e bëj çdo vit për shkollat profesionale. Duke i përqendruar këto vetëm në bashkitë e qendrave, rriten edhe shpenzimet e fermerëve, për shembull atij fermerit që kam unë në Çorrush të Mallakastrës për të vajtur në Fier, që është 60 kilometra larg. Po vajti në Fier, ai thotë: “Më mirë po shkoj në Tiranë”. Në njëfarë mënyre nxisim edhe largimin e njerëzve nga fshati. Si zgjidhet kjo? Bëni shkolla të bashkuara, bëni marketing të fortë, sipas kërkesës dhe ofertës që ka tregu i punës për çdo zonë.

Unë nuk them që këtë ta bëni në çdo bashki dhe në çdo njësi administrative. Ne na kanë rezultuar shumë të suksesshme sot edhe shkollat si qendër komunitare. Drejtuesja e komisionit ka qenë ministre, ka dhënë një kontribut për këtë reformë.

Është realitet lëvizja e njerëzve, por ky është një element tjetër, nuk është njëlloj. Shifra është kokëfortë: 3,3% është trendi i rritjes së të regjistruarve për 10 vjet. Unë nuk jam dakord, si specialist, si inxhinier kimist, si teknolog që kam punuar, si profesor që jam tani në universitet. Kështu nuk e zhvillojmë dot as bujqësinë, as industrinë, as nevojat që ka turizmi. A e dini që nëpër bashki është kiameti i zi, se nuk gjen një teknik ndërtimi për të bërë preventivat e punimeve që bëjnë?! Një teknik ndërtimi nuk gjen dot.

**Evis Kushi** – Zoti Beqiraj, faleminderit për ndërhyrjen!

Atëherë, zonja Tahiraj do të bëjë një ndërhyrje të shkurtër. Më pas, do ta marrë fjalën zonja Manjani për ta përmbyllur, duke sqaruar edhe detajet e fundit.

**Dasantila Tahiraj** – Unë, në fakt, kam dy ndërhyrje: një për procedurë dhe një pyetje për zonjën Manjani.

Së pari, dua t’i them zonjës Ina Zhupa se në mbledhjen e fundit, të cilën ne kërkuam ta zhvillonim në sallën e komisionit, ndodhi një incident i papranueshëm me një nga koleget tona të nderuara, zonjën Gjylameti, e cila kërkonte, në zbatim të Kushtetutës, të merrte pjesë në mbledhjen e komisionit, por iu bllokua dera nga kolegët e opozitës dhe në të njëjtën kohë u pengua, duke u prekur me dorë dhe duke ngritur gjurin ndaj njëres prej kolegeve tona.

Meqenëse në këtë komision kemi zonjën Merita Bakiu, e cila është kryetare e Aleancës së Grave Deputete, kërkoj që ndaj këtij deputeti të mbahet një qëndrim nga Aleanca e Grave Deputete.

Së dyti, sa u përket pyetjeve për zonjën zëvendësministre, në programin e punësimit shikoj edhe mësimin e profesionit në vendin e punës. Si do të incentivohet kjo pikë te bizneset private, sepse zakonisht bizneset private kërkojnë të marrin profesionistë? A do të

incentivohet nga qeveria? Në ç'formë do të incentivohet, që të marrë një punonjës pa profesion dhe profesioni të mësohet në vendin e punës në bizneset private?

Faleminderit!

**Evis Kushi** – Faleminderit për pyetjen, zonja Tahiraj!

Faleminderit që na e solle edhe një herë në vëmendje incidentin që ndodhi javën e kaluar me deputeten e mazhorancës, zonjën Gjylameti, si dhe problematikën që shkaktuan deputetët e opozitës!

Kështu që, edhe unë i bashkohem kërkesës suaj, që të mbahet një qëndrim, sidomos për faktin që zonjën Bakiu, kryetaren e Aleancës, e kemi anëtare të këtij komisioni.

Zonja Manjani, fjala për ju, për ta përmbyllur, por, ju lutem, sa më shkurt!

**Olta Manjani** – Faleminderit!

Do të përpiqem të flas shkurt, sepse një pjesë e mirë e gjërave u thanë.

Lidhur me shqetësimin që ngriti zoti Beqiraj, është i drejtë, megjithatë dihet se ndryshimet demografike kanë ndikuar në këto shifra, që lidhen qoftë me plakjen e popullsisë, qoftë me largimin për çështjen e emigracioni, ndaj edhe ruajtja e peshës së nxënësve në arsimin profesional ndaj totalit të kësaj grupmoshe është sfidë më vete. Për më tepër, rritja 17,7%, brenda një harku kohor, në 18,3%, pra një rritje me 0,5 pikë përqindjeje, e peshës së nxënësve, që studiojnë në arsimin profesional, është e konsiderueshme, duke mbajtur parasysh të gjitha zhvillimet demografike, që lidhen edhe me zhvillimet e brendshme demografike, pra me urbanizimin dhe kalimin e popullsisë nga zonat rurale në zonat urbane.

Jemi të gjithë të vetëdijshëm që ka një rritje të procesit të urbanizimit, automatikisht kjo sjell përqendrimin e shkollave profesionale dhe interesit më të madh për të investuar në qendrat urbane.

Megjithatë, unë ia dhashë përgjigjen zotit Beqiraj kur fola edhe për ndërtimin e konvikteve dhe rritjen e numrit të konvikteve, për t'u dhënë mundësi të gjithë atyre studentëve që jetojnë në zonat rurale, që të paktën shkollën ta përfundojnë në këto zona urbane dhe më pas të kthehen dhe të shërbejnë në vendet e tyre.

Nga ana tjetër, në lidhje me decentralizimin, dua t'ju informoj që ka edhe një urdhër ministri për autonominë financiare të shkollave, që do të thotë se nuk është e nevojshme që të jenë bashkitë që përfshihen në këtë proces, pasi vetë shkollat tanimë për herë të parë janë në gjendje që të kenë autonominë e tyre financiare. Kjo do të thotë se mund të gjenerojnë të ardhurat e tyre nga produktet që ata prodhojnë, pasi shumë shkolla prodhojnë vetë produkte bujqësore, produkte industriale, të cilat mund t'i shesin konform të gjitha ligjeve që ka shteti

shqiptar, ndërkohë gjenerojnë të ardhura, të cilat mund t'i përdorin për të intensifikuar qoftë veprimtarinë prodhuese të shkollës, qoftë për të përmbushur nevojat që mund të kenë, përveçse të jenë të varura nga buxheti i shtetit.

Ky është një urdhër, i cili ka hyrë në fuqi para disa muajsh dhe u garanton shkollave menaxhimin e burimeve të tyre financiare.

Nga ana tjetër, siç e thamë, ne kemi ngritur qendrat shumëfunktionale, pra do të ngremë qendrat shumëfunktionale, në kuadër të procesit të optimizimit, i cili ka filluar me përqendrimin dhe bashkimin e shkollave në disa pole. Në një fazë të dytë të procesit të optimizimit do të ketë dhe bashkime në qendrat e formimit profesional, të cilat do t'u bashkohen shkollave për të krijuar të ashtuquajtur shkolla shumëfunktionale, që do të ofrojnë një shumëllojshmëri shërbimesh, përfshirë edhe ofrimin e kurseve afatshkurtra, pasi tregu nuk ka nevojë vetëm për kurse afatgjata, pra për shkolla afatgjata 2 plus 1 plus 1, pra nga 2-vjeçare deri në 4-vjeçare, por edhe ofrimin e kurseve afatshkurtra për riaftësimin asaj popullsie, të cilët, për shkak të zhvillimit të shpejtë të teknologjisë, kanë nevojë të riaftësohen në profesionet që ata kanë. Ndërkohë, ne kemi edhe një qendër lëvizëse, pra për të plotësuar nevojat e popullatës për t'u riaftësuar dhe për të marrë aftësi në të gjithë Shqipërinë lëviz edhe një shkollë profesionale, që quhet qendër lëvizëse, e cila u përgjigjet nevojave imediate që ka tregu për zhvillimin e aftësimit.

Ndërkohë, për të kaluar te pyetja që ngriti zonja Tahiraj, mësimi i profesionit në vendin e punës, aktualisht të gjithë nxënësit, siç thashë, pra mbi 90% e të gjithë nxënësve, që janë të regjistruar në shkollat e arsimit profesional, kryejnë praktikën profesionale qoftë në laboratorët e praktikave profesionale pranë shkollave të tyre, qoftë pranë bizneseve. Megjithatë, qëllimi i qeverisë shqiptare është ta intensifikojë kryerjen e praktikave pranë bizneseve. Kemi disa elemente të sistemit dual, sistemi dual, mënyra si funksionon në shtetet që e aplikojnë si në Zvicër, Gjermani apo Austri, funksionon në mënyrë të tillë, ku nga 5 ditë të javës 4 ditë prej tyre nxënësit kryejnë praktikën profesionale pranë biznesit dhe 1 ditë marrin formimin teorik në ambientet e shkollës.

Sigurisht, kjo do shumë bashkëpunim edhe me bizneset. Pra, fillimisht biznesi duhet të përgatitet, në mënyrë që të ketë mundësi të investojë kaq shumë kohë dhe resurse për mikpritjen e nxënësve në ambientet e tij të punës, pasi nuk është e lehtë që rreth 80% të kohës ata t'i përgjigjen këtij sistemi, pra t'i mbajnë nxënësit dhe t'i monitorojnë pranë ambienteve të tyre të punës. Megjithatë, elemente të këtij sistemi ne po i aplikojmë, nxënësit shpenzojnë mjaftueshëm kohë pranë ambienteve të biznesit për kryerjen e praktikave profesionale.

Qëllimi është që në të ardhmen ky bashkëpunim të intensifikohet, kuptohet pasi edhe biznesi të ndërgjegjësohet për të gjithë impenjimin që ai duhet të ndërmarrë në kuadër të këtij procesi.

Faleminderit!

**Evis Kushi** – Zonja Manjani, faleminderit për të gjitha shpjegimet tuaja!

Ju ishit në komision edhe para pak javësh, për të diskutuar së bashku për masat e marra për vitin shkollor 2023-2024 në arsimin profesional. Unë ju përgëzoj për të gjithë angazhimin tuaj, për përkushtimin tuaj dhe për gatishmërinë që keni për të qenë e pranishme në këtë komision, për të ndarë bashkë ecurinë e politikave, pse jo, për t'ju shprehur edhe ne, nga ana jonë, mbështetjen e plotë për zhvillimin e mëtejshëm të arsimit profesional!

Kështu që, këtë komision do ta keni gjithmonë mbështetje në të mirë të punës, në të mirë të nxënësve dhe në zhvillim të arsimit dhe formimit profesional.

**Olta Manjani** – Faleminderit!

*Mbyllet pika e parë e rendit të ditës*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 13.11.2023, ora 14:00

**Drejton mbledhjen:**

**Evis Kushi – nënkryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

2. Seancë dëgjimore me Qendrën Kombëtare të Kinematografisë për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”.

**Marrin pjesë:**

Evis Kushi, Lindita Buxheli, Petro Koçi, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Ilir Topi, Ilir Metaj, Blerina Gjylameti, Florenc Spaho, Dasantila Tahiraj, Enslemvera Zake, Meri Markiçi, Ina Zhupa, Eralda Bano, Merita Bakiu, Kastriot Piroli, Orjela Nebijaj dhe Ismet Beqiraj (zëvendësues).

**Mungojnë:**

Flutura Açka, Agron Gjekmarkaj dhe Andia Ulliri.

**Të ftuar:**

Arben Lami – drejtor në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë,

Marjela Zajmi – përgjegjëse Sektori në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë,

Shqiponja Dauti – juriste në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë,

Gentian Opre – drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

## *Vijon pika e dytë e rendit të ditës*

**Evis Kushi** – Viojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, seancë dëgjimore me Qendrën Kombëtare të Kinematografisë për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”.

Kemi të ftuar në komision zonjën Zerina Bruci, sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Kulturës; zotin Arben Lami, drejtor në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë, zonjën Marie Lazanji, përgjegjëse sektori, dhe zonjën Shqiponja Dauti, juriste. Faleminderit!

Fjalën e ka drejtori, zoti Arben Lami, për të bërë një prezantim të projektbuxhetit për vitin 2024. Më pas, do të hapim seancën e pyetjeve dhe të diskutimeve me kolegët e komisionit.

**Arben Lami** – Përshëndetje!

Unë jam Arben Lami, drejtor në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë, zonja Bruci kishte një angazhim dhe nuk ndodhet për momentin, kështu që, besoj e keni përpara të gjithë materialin, të cilin jua kemi dërguar.

Qendra Kombëtare e Kinematografisë për momentin, me iniciativën e ministres së Kulturës, zonja Margariti, ka marrë iniciativën për ndryshimin e ligjit për kinematografinë, duke u mbështetur në ligjin francez të filmit. Kjo iniciativë erdhi për shkak se ligji i kinematografisë duhet të përshtatet sa më shumë me të rejtat e fundit të kinematografisë .

Qendra Kombëtare e Kinematografisë edhe në vitin 2020 ka bërë disa propozime për ndryshimin e ligjit të Kinematografisë, të cilat ishin për të mos ndryshuar komplet ligjin, por disa nene të tij, që u kishte kaluar koha. Megjithatë, nga Ministria e Kulturës u pa e arsyeshme që ligji të ndryshojë tërësisht. Kryesorja në këtë projektligj të kinematografisë do të ishte futja e inventivës së *cash rebate*, gjithashtu, edhe *film commission*, e cila ka në thelb promovimin e territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe thithjen e të gjithë kompanive të huaja filmike, të cilat kanë dëshirë të xhirojnë në Shqipëri. Në fakt, gjatë kësaj periudhe, të themi të drejtën, në vendin tonë kanë ardhur shumë kompani filmike, të cilat, në bashkëprodhim me kompanitë shqiptare të filmit, kanë prodhuar film. Pyetja e parë e tyre ka qenë: a është në ligjin tuaj *cash rebate*? Nëpërmjet kësaj incentive, duke xhiruar në Shqipëri, në bazë të këtij ligji, mund t’u kthehen, në bazë të shpenzimeve, 31% të shpenzimeve, të cilat janë të justifikuar me dokumentacion. Kjo ka qenë një nga arsyet kryesore që duhej të futej në ligj *cash rebate*. Gjithashtu, edhe *film commission* është një institucion, i cili promovon Shqipërinë, duke reklamuar lokacionet, që u themi ne në gjuhën filmike, pra vendet e



xhirimit. Gjithashtu, duke pasur parasysh që në vendin tonë të gjithë specialistët kanë një pagë më të ulët se vendet e tjera, të gjitha kompanitë e huaja duan të xhirojnë në Shqipëri, duke pasur parasysh që vendi ynë është edhe një vend, i cili në distanca të vogla ka afër detin, malin, kodrën, ka shumë kështjella, që mund të përdoren për filmin, por edhe shumë vende të tjera, që janë atraktive për xhirimet në Shqipëri. Kjo ka qenë arsyeja kryesore që Ministria e Kulturës dhe vetë zonja Margariti ka marrë iniciativë për ndryshimin e ligjit, si dhe për të futur në ligj edhe *cash rebate*, edhe *film commission*.

Sa i përket buxhetit të vitit 2024, Qendra Kombëtare e Kinematografisë ka një buxhet prej 161 milionë lekësh, të cilat, sipas detajimit të buxhetit, janë ndarë: 8 milionë e 532 mijë lekë janë paga; 1 milion e 358 mijë janë sigurime; 4 milionë janë shpenzime operative; 131 mijë e 110 lekë janë projekte kinematografike dhe 16 mijë janë transferta nga jashtë.

Duke parë buxhetin e qendrës, në gjithë këtë buxhet pagat dhe sigurimet zënë rreth 6,5%. Qendra ka një administratë shumë të vogël, maksimumi 9 veta, dhe të gjitha shpenzimet për projektet kinematografike i organizojmë në një periudhë shumë të shkurtër.

Ne këtë vit kërkojmë rreth 10 milionë lekë buxhet më tepër, sepse kemi një aktmarrëveshje me Ministrinë e Kulturës dhe me Universitetin e Arteve që të financojmë prodhimin e çdo film diplome të studentëve të *bachelor*-it. Është viti i katërt që ne i financojmë, por këto lekë ia heqim buxhetit të projekteve kinematografike. Megjithëse ne e kemi bërë çdo vit këtë kërkesë, nuk është marrë parasysh kjo shtesë prej 10 milionë lekësh.

Për të tjerat, t'ju them të vërtetën, për kineastët do të donim që buxheti të dyfishohej, por jemi të qartë se sa mund të na shtohet. Materialin e keni para, por, nëse keni pyetje, jam në dispozicionin tuaj t'ju përgjigjem.

**Evis Kushi** - Faleminderit, për prezantimin!

Po ua kaloj menjëherë fjalën kolegëve për ndonjë pyetje apo diskutim të mundshëm, qoftë në lidhje me materialin që na ka ardhur para disa ditësh në komision, qoftë edhe për prezantimin dhe për shpjegimet që bëri zoti Lami.

Kush e kërkon fjalën, kolegë?

Meqenëse kolegët nuk kanë pyetje, unë, në fakt, duke iu referuar edhe materialit që kemi para, do të doja t'ju pyesja për ndryshimet ligjore. Këtë shqetësim e keni paraqitur edhe në material, po kështu edhe në fjalën tuaj. Ju thoni se keni 2 vite buxhetore që jeni në pritje të ndryshimeve ligjore. Pikërisht, për këtë arsye keni paraqitur vetëm një projekt shtesë, që lidhet me filmat e diplomës së studentëve të degës “Regji filmi dhe TV”, të Universitetit të Arteve. A mund të na thoni diçka më tepër lidhur me nevojat për këto ndryshime ligjore? A

po punohet për këto ndryshime? Çfarë mbështetje ju duhet nga ana jonë, si komision? Pra, mund të na thoni diçka më tepër lidhur me këtë, sepse të gjithë jemi të interesuar që puna të vijojë dhe ndryshimet ligjore të mos bëhen pengesë për rezultatet e punës suaj dhe për progresin në realizimin e misionit dhe objektivave tuaj.

Fjala për ju.

**Arben Lami** – Pas marrëveshjes që u bë mes Ministrit të Kulturës dhe Qendrës së Filmit Francez, është ngritur një komision, i cili po merret me ndryshimet ligjore. Komisioni ka bërë të paktën dy mbledhje dhe vazhdon akoma. Në komision janë përfaqësues nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë, përfaqësues nga Ministria e Kulturës, pritet të vijnë edhe specialistët nga C&C-ja franceze. Lidhur me ndryshimet ligjore, janë bërë 2 takime, në fakt, nesër është një takim i tretë, i cili do të ketë në thelb ndryshimet ligjore kryesore, sepse ligji për kinematografinë është një ligj i miratuar në vitin 1997, janë bërë disa ndryshime në vitin 2005, siç ju thashë, në vitin 2020 ne kërkuam disa ndryshime ligjore, por jo ndryshimin e ligjit në tërësi.

Për momentin mendojmë se duhet të ketë një reformë për ligjin për kinematografinë.

Lidhur me këtë, jam shpresëplotë se do të jetë një ligj modern, sepse C&C-ja franceze është një nga institucionet pararojë për të gjithë Europën. Nuk e di sa kohë do të marrë kjo gjë, por t'ju them të drejtën është marrë me shumë seriozitet që këto ndryshime ligjore të bëhen sa më shpejt.

Për momentin, për vitin 2024 mendoj se do të jemi me këtë buxhet dhe do të veprohët me këtë ligj, sepse, pasi ne të bëjmë ndryshimet ligjore, kjo gjë do të konsultohet edhe me kineastët apo me grupet e interesit, më pas do të kalojë në çdo ministri, siç veprohët për çdo ndryshim ligjor, kështu që në këtë rrugë jemi. Faleminderit!

**Evis Kushi** - Shumë faleminderit, për prezantimin, zoti Lami!

Faleminderit, gjithashtu, për punën që bëni, që, edhe pse me një buxhet modest dhe me një staf të kufizuar, punoni me përkushtim për të përmbushur misionin tuaj!

Komisionin tonë do ta keni mbështetje, e përsëris. Presim me padurim ndryshimet ligjore. Deri atëherë, ju urojmë punë të mbarë!

**Arben Lami** – Faleminderit!

*Mbyllet pika e dytë e rendit të ditës*



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*

#### **PROCESVERBAL**

Tiranë, më 13.11.2023, ora 14:30

#### **Drejton mbledhjen:**

**Evis Kushi – zëvendëskryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

3. Seancë dëgjimore me drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë për Media dhe Informim, zotin Alteo Hysi, për diskutimin në parim të projektligjit "Për buxhetin e vitit 2024".

#### **Marrin pjesë:**

Evis Kushi, Lindita Buxheli, Petro Koçi, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Ilir Topi, Ilir Metaj, Blerina Gjylameti, Florenc Spaho, Dasantila Tahiraj, Enslemvera Zake, Meri Markiçi, Ina Zhupa, Eralda Bano, Merita Bakiu, Kastriot Piroli, Orjela Nebijaj dhe Ismet Beqiraj (zëvendësues).

#### **Mungojnë:**

Flutura Açka, Agron Gjekmarkaj dhe Andia Ulliri.

#### **Të ftuar:**

Alteo Hysi - drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Media dhe Informim,  
Gentian Opre – drejtor i Përgjithshëm i Buxhetit në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave.

### *Vijon pika e tretë e rendit të ditës*

**Evis Kushi** – Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, seancë dëgjimore me drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë për Media dhe Informim për diskutimin në parim të projektligjit "Për buxhetin e vitit 2024".

Nga Agjencia për Mediet dhe Informim kemi të ftuar zotin Alteo Hysi, drejtor i Përgjithshëm.

Faleminderit për prezencën!

Po jua kaloj menjëherë fjalën për të prezantuar buxhetin, më pas do t'ua kaloj fjalën kolegëve deputetë për të bërë pyetje dhe diskutime.

**Alteo Hysi** – Përshëndetje!

Faleminderit, zonja Kushi!

Faleminderit, të nderuar deputetë!

Faleminderit, që na dhatë mundësinë të paraqesim para jush një prezantim të shkurtër të kërkesave tona buxhetore për vitin 2024!

Fillimisht më duhet të qartësoj se këto kërkesa të Agjencisë për Media dhe Informim janë hartuar në përputhje si me misionin e përgjithshëm të agjencisë sonë, ashtu edhe me parashikimet e nevojave për vitin 2024, por në të njëjtën kohë edhe me një analizë të shpenzimeve faktike për vitin që po lëmë pas, pra për vitin 2023, sigurisht në përputhje me të gjitha tavanet përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm, të miratuar tashmë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Sikurse e dini, Agjencia për Media dhe Informim është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 512, të vitit 2021, dhe më tej është organizuar sipas urdhrave të Kryeministrit për rregulloren, për strukturën apo organikën e agjencisë.

Agjencia për Media dhe Informim ka si mision të sigurojë transparencën në lidhje me të gjitha politikat, risitë, projektet, eventet, si dhe qëllimin apo problematikat, që zgjidhen nëpërmjet akteve të Këshillit të Ministrave, të ministrave dhe të institucioneve të tjera në varësi.

Në kuadër të këtij misioni, Agjencia është organizuar në 5 departamente kryesore, të cilat kanë këto objektiva për të përmbushur:

Së pari, Departamenti për Informimin e Qytetarëve, i cili shfrytëzon të gjitha mjetet e komunikimit masiv për të informuar qytetarët për nismat, vendimet dhe politikat e qeverisë.

Së dyti, Departamenti i Informimit të Medies, i cili kujdeset për informimin e medies për vendimet e politikat, por njëkohësisht menaxhon edhe marrëdhëniet e përditshme me gazetarët në vend, por edhe me medien e huaj.

Departamenti i tretë kujdeset për dhënien e informacionit të qytetarët dhe media për veprimtarinë e ministrive dhe agjencive të varësisë përmes koordinimit ndërinstitucional, midis MIA-s dhe ministrive të tjera.

Departamenti i Informimit të Institucioneve, Hulumentimit dhe Përmbajtjes, i cili kujdeset për të informuar në kohë reale dhe në mënyrë të saktë Këshillin e Ministrave, Kryeministrin dhe agjenci të tjera në varësi për të gjitha zhvillimet publike në vend apo raportimet mediatike, në mënyrë që qeveria apo drejtuesit kryesorë të jenë të informuar për atë se çfarë ndodh në kohë reale në të gjithë vendin dhe përtej vendit.

Gjithashtu, kemi një departament të pestë, që kujdeset për organizimin e aktiviteteve publike të Kryeministrit dhe Këshillit të Ministrave, njëkohësisht edhe për realizimin produksionit dhe postproduksionit të materialeve për publikun lidhur me këto organizime.

Më lejoni të sqaroj, të nderuar deputetë, se këto objektiva mbeten të njëjta dhe të pandryshuara edhe për vitin 2024.

Bazuar mbi këtë veprimtari, si dhe në analizën e shpenzimeve që ne kemi bërë për vitin 2023, në projektbuxhetin e vitit 2024 kemi kërkuar një fond total prej 160 milionë e 540 mijë lekësh. Dua të theksoj se në këtë vlerë totale është reflektuar edhe efekti financiar shtesë, që vjen si rrjedhojë e të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore të politikës së rritjes së pagave, të cilën ju tanimë e dini që është bërë realitet, pra paga e rritur për punonjësit e administratën publike në Republikën e Shqipërisë. Nga vlera totale që sapo përmenda, 127 milionë e 461 mijë lekë janë fond pagash dhe sigurimesh, konkretisht shprehur në zërat 600 dhe 601.

Fondi i pagës për 69 persona, sipas organikës dhe niveleve të pagave, parashikohet në vlerën 109 milionë e 221 mijë lekë, si dhe fondi i sigurimeve parashikohet në vlerën 18 milionë e 240 mijë lekë.

Fondi total i pagave dhe sigurimeve për vitin 2024 përbën rreth 79% të totalit të kërkesave buxhetore të Agjencisë për Medie dhe Informim.

Për sa u përket shpenzimeve operative, Agjencia për Medie dhe Informim ka kërkuar një fond total prej 33 milionë e 79 mijë lekësh. Llogaritja e fondit për shpenzimet operative

(602) është bërë duke u bazuar tek objektivat, struktura e Agjencisë, patjetër edhe analiza e shpenzimeve operative të vitit 2023.

Për sa i përket fondit të investimeve kapitale të brendshme dhe të huaja për zërat konkretë 230 – 232, Agjencia për Medie dhe Informim nuk ka kërkesa në projektbuxhetin e vitit 2024, pasi nuk parashikohet të kryhen investime kapitale për këtë vit. Për rrjedhojë kërkesat buxhetore të Agjencisë për Medie dhe Informim për vitin 2024 pasqyrojnë vetëm totalin e shpenzimeve korrente me zërat e pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe shpenzimet operative.

Mbetem i hapur për pyetje.

Faleminderit!

**Evis Kushi** – Faleminderit, për shpjegimet lidhur me buxhetin!

Faleminderit, gjithashtu, që na shpjeguat edhe një herë misionin e institucionit tuaj dhe strukturën, mënyrën se si është e organizuar!

Pyetja e parë që më lind, në fakt, para se t'ua jap fjalën kolegëve, lidhet pikërisht me kontributin e këtij institucioni. Ju jeni institucion i ri, është një agjenci që ka pak vite që është ngritur. Çfarë kontributi konkret ka sjellë në aspektin e komunikimit? Cilat janë risitë që ka sjellë ky institucion në aspektet e komunikimit? Pra, a mund të jeni pak më konkretë, që edhe ne ta kuptojmë vlerën që ka ky institucion?

Faleminderit!

**Alteo Hysi** – Faleminderit për pyetjen, zonja Kushi!

Është një pyetje shumë e mirë, që edhe ne na jep mundësinë të tregojmë se çfarë bën konkretisht Agjencia për Mediet dhe Informim.

Pak më parë theksova që misioni ynë është garantimi i transparencës publike në lidhje me të gjithë aktivitetin, nismat dhe politikat që ndërmerr qeveria shqiptare. E shprehur kjo në rezultate konkrete, do të thotë se vetëm përgjatë vitit 2022 ne kemi realizuar një format, që ishte risi në komunikimin publik të qeverisë shqiptare, jo vetëm qeverisë aktuale, por kam përshtypjen e të gjitha qeverive të mëparshme në Republikën e Shqipërisë, ai i konferencave për shtyp të mbajtura pas mbledhjes së qeverisë që zhvillohet në godinën e Kryeministrit, ku gazetarët janë të lirë të bëjnë pyetje lidhur me çfarë është vendosur apo diskutuar në mbledhjet e qeverisë, por jo vetëm, hapësira ekziston edhe për pyetje për çështje të aktualitetit apo çështje me ndjeshmëri publike.

Konkretisht, lidhur me këtë format, vetëm për periudhën janar-tetor 2023 janë bërë 45 konferenca për shtyp të organizuara si për Kryeministrin, ashtu edhe për anëtarët e Këshillit

të Ministrave, ku përfshihen, siç e thashë, pyetje apo komunikime të gazetarëve për çështje nga më të ndryshmet. Besoj se të gjithë e keni parë se në ato dalje publike jashtë godinës së Kryeministrit, jashtë dyerve të mbyllura, gazetarët janë të lirë të pyesin për çështje, që realisht shqetësojnë opinionin publik në Shqipëri.

Për vitin e parë të Agjencisë, për vitin 2022, kjo shifër e këtij formati ka qenë 123, pra janë 123 dalje apo konferenca jashtë godinës së Kryeministrit në komunikim me gazetarët. Por ky është vetëm një nga indikatorët e performacës së Agjencisë për Mediet dhe Informim.

Kur flasim për të drejtën e informimit, zonja Kushi, dhe të nderuar deputetë, besoj se është shumë thelbësor raporti i institucioneve publike me gazetarët, të cilët dërgojnë pyetje, dërgojnë kërkesa për informim në rrugë shkresore, në zbatim të ligjit “Për të drejtën e informimit”. Ne kemi një departament të posaçëm që kujdeset për këtë dhe drejtuesi i Departamentit për Informimin e Medieve është edhe koordinatori i institucionit tonë për të drejtën e informimit. Pra, roli i koordinatorit për të drejtën e informimit i është besuar një zyrtari në nivel drejtues, në mënyrë që edhe përgjegjësia të jetë më e madhe në raport me ligjin dhe me gazetarët, marrëdhëniet me të cilët ky drejtues i ruan në baza ditore.

Dua të them se mesatarja e kthimit të përgjigjeve në rrugë zyrtare është 3 deri në 4 ditë për gazetarët që i drejtohen Agjencisë për Medie dhe Informim për të marrë informacion. Në rastet kur ka kërkesa për një koment apo një qëndrim të qeverisë shqiptare, që vijnë jo në rrugë shkresore, por përmes telefonit apo mjeteve të tjera të komunikimit, kjo mesatare është vetëm një ditë. Në të shumtën e rasteve gazetarëve u kthehet përgjigje brenda ditës apo pak pas momentit kur ata e kanë dërguar pyetjen e tyre.

Rezultati ynë është edhe më konkret në punën që bën Departamenti për Informimin e Qytetarëve, i cili shfrytëzon mjetet e komunikimit masiv për t’i informuar në kohë reale me informacion të saktë dhe të besueshëm qytetarët shqiptarë. Edhe këtu një fokus i veçantë i kushtohet fushatave informuese që kanë të bëjnë me çështjet me ndjeshmëri për publikun. Për shembull, gjatë vitit 2022 ky departament ka realizuar disa fushata shumë të rëndësishme për publikun, siç ishte ajo e paketës së rezistencës sociale. Pra, ju e dini se pas një krize shumë të madhe që përfshiu Europën qeveria shqiptare mori disa nisma të rëndësishme financiare dhe publiku kishte nevojë të dinte se çfarë përmbante kjo paketë; kush përfitonte dhe sa përfitonte. Ndaj, ne i kemi shfrytëzuar të gjitha mjetet e komunikimit masiv, të gjitha mjetet e komunikimit *online*, por edhe ato tradicionale për t’i komunikuar publikut se kush përfiton dhe çfarë përfiton.

Në thelb, mendimi im profesional është se ky është misioni i strukturave të tilla të komunikimit: t'i ndihmojë qytetarët që të marrin informacion të saktë dhe në fund të ditës të bëjnë zgjedhje të arsyetuara e të bazuara mbi një informacion të saktë dhe të besueshëm. Flas këtu për zgjedhje që kanë të bëjnë me jetesën e përditshme.

Meqenëse përmenda mjetet e komunikimit, dua të them se kemi bërë një rikonceptim të të gjitha faqeve zyrtare, qoftë të Kryeministrit, qoftë të MIA-s vetë, dhe rrjeteve sociale për t'i bërë ato më të aksesueshme nga publiku. Sigurisht, kjo ka sjellë një fluks shumë më të madh vizitorësh në faqet tona.

Në të njëjtën kohë kemi futur edhe traditën e buletinit mujor, ku është një përmbledhje mujore e të gjitha aktiviteteve kryesore të ministrive dhe strukturave të tyre të varësisë, i cili gjendet si në formatin *online*, por edhe i printuar, sepse në fund të ditës çdokush ka nevojë të dijë se kush bën çfarë, pra cili institucion prodhon çfarë.

Nuk dua të lë pas edhe punën, pra raportet që ne kemi me institucionet e varësisë. Këtu dua të bëj një sqarim: raporti ynë me ministritë e tjera apo me agjencitë e tjera të varësisë është thjesht dhe vetëm koordinues. Më duhet të sqaroj se gazetarët janë të lirë të marrin informacionin që duan tek institucioni përgjegjës për atë fushë veprimtarie. Pra, jo më domosdoshmërisht gazetari duhet të vijë te MIA për të marrë informacionin që kërkon, por mund të shkojë ose mund të nisë një kërkesë me shkrim për ta marrë informacionin në institucionin përgjegjës.

Ajo çfarë ne bëjmë është: të japim përgjigje kur çështjet kërkojnë një qëndrim apo një koment të qeverisë shqiptare, por në asnjë moment ne nuk marrim përsipër të shpërndajmë dokumente që nuk prodhohen nga MIA.

Pak më parë u gëzova kur pashë se në mbledhje ishte edhe zonja Zhupa, sepse shpresoja që do të kishim mundësi të dialogonim dhe të komunikonim, në mënyrë që edhe asaj t'ia hiqja merakun e kontrollit të informacionit. Ne edhe më herët kemi pasur mundësi të komunikojmë me të, por gjithsesi po e ritheksoj se ne thjesht koordinohemi me të gjitha institucionet e tjera për çështje ndërsektoriale.

Para disa vjetësh gazetarëve u duhej të trokisnin në shumë dyer për të marrë informacione për një çështje specifike, që lidhej me punën e shumë institucioneve, ndërsa tani, patjetër që mund të shkojnë te X institucion për ta marrë informacionin që kërkojnë, por MIA është si një dritare për koordinimin e informacionit. Ne në asnjë moment nuk mbivendosim punën e institucioneve të tjera.

Faleminderit!



**Evis Kushi** – Zoti Hysi, faleminderit për shpjegimet tuaja!

Edhe unë u gëzova që disa nga deputetët e opozitës u bashkuan me ne në këtë mbledhje, por, me sa duket, kanë vendosur të mos jenë aktivë në shqyrtimin e buxhetit. Le të shpresojmë që ....

E vetmja deputete e opozitës që ka mbetur *online* po kërkon fjalën.

Po, zonja Nebijaj, fjala për ju.

**Orjela Nebijaj** – A dëgjohem, zonja Kushi?

**Evis Kushi** – Po, dëgjoheni.

**Orjela Nebijaj** – Meqenëse na përshëndetët, unë kam qenë shumë e vëmendshme dhe kam dëgjuar çdo gjë që është diskutuar deri tani. Për sa kohë që jemi duke diskutuar në parim, të gjithë mund të marrim kohën dhe mundësinë për të dhënë argumente dhe për të drejtuar pyetje në lidhje me ato që duhet të miratohen.

Unë e dëgjova drejtorin me vëmendje, por jam e paqartë se ku qëndron nevoja e këtij institucioni për të ekzistuar me një buxhet të veçantë, në një kohë kur shqiptarët kanë kërkesa shumë më imediate që mund të realizohen qoftë edhe me buxhete të vogla.

Gjithashtu, dua të di, përveç nevojës që lidhej me pyetjen tuaj konkrete, së pari, a ka ky institucion për kohën që ka operuar një shifër konkrete ose një anketim se si gazetarët e të gjitha medieve në rang kombëtar, qofshin këto publike apo të pavarura, janë ndjerë në këtë bashkëpunim dhe sa u është lehtësuar puna? Do të doja një shifër konkrete, jo thjesht një opinion, se opinionet në këtë komision mund t'ia kursejmë njëri-tjetrit.

Ku ndryshon MIA nga ATSH-ja konkretisht, qoftë edhe për mënyrën se si funksionon, duke konsideruar se të gjitha institucionet shtetërore, si Kryeministria apo ministritë, kryesisht i kanë zyrat e shtypit, nga të cilat drejtuesit kanë komunikimin me medien?

Një saktësim për drejtorin: një gazetar e ka për detyrim të konfirmojë çdo informacion në disa burime, por centralizimi i informacionit nuk është asnjëherë një gjë e mirë për medien dhe për pavarësinë që ajo duhet të ketë.

Faleminderit!

**Evis Kushi** – Faleminderit, zonja Nebijaj!

Fjala për zotin Hysi, për sqarime të mëtejshme.

**Alteo Hysi** – Faleminderit për pyetjet, zonja Nebijaj!

Në fakt, po ritheksoj se, me ngritjen e MIA-s, asgjë nuk ka ndryshuar në raportin mes institucioneve publike dhe gazetarëve. Ngritja e MIA-s as nuk i ka tjetërsuar dhe as nuk ka

kufizuar raportet e gazetarëve me institucionet publike. MIA shërben si një dritare, si një *one stop shop*, siç mund të quhet ndryshe, në rastet kur çështjet janë ndërsektoriale dhe nevojitet të merret një informacion në kohë më të shkurtër, i mirëkoordinuar mes shumë institucioneve të përfshira në një çështje të caktuar.

E bëra këtë saktësim, zonja Nebijaj, jo se nuk e di që gazetarët mund t'i rishikojnë burimet, sepse vetë jam një ish-student i gazetarisë, por për të saktësuar kolegën tuaj, zonjën Zhupa, që ngritja e MIA-s nuk i ka centralizuar raportet komunikuese të qeverisë shqiptare apo të institucioneve të tjera të varësisë me gazetarët.

Ne jemi shumë të vëmendshëm te perceptimi që kanë gazetarët, organizatat e medias, veçanërisht organizatat ndërkombëtare për rolin dhe punën e MIA-s.

Këtu do të ndaj një eksperiencë. Para disa muajsh kisha në zyrën time një nga ekspertët e TAIEX-it, që është misioni i Asistencës Teknike dhe Shkëmbimit të Informacionit të Komisionit Europian, i cili erdhi me perceptimin e marrë nga disa aktorë publikë në vend apo nga disa organizata medietike që MIA po centralizon informacionin. Pyetja ime konkrete ishte: a ka raste konkrete, ku ne i kemi ndaluar gazetarët e një institucioni publik apo në të kundërt institucionin publik ta kemi ndaluar për të marrë informacion vetëm se duhet të vijë te ne? Pas sqarimit, të gjithë e kuptuan se ky është thjesht një perceptim. Kjo ngjarje, për mua si drejtues i agjencisë, më bëri të mendoj se duhet të komunikojmë më shumë me publikun për atë që bëjmë ne, sepse perceptimet janë nga më të ndryshmet. Ndoshta do të na duhet një qasje më proaktive për të komunikuar atë çfarë bën MIA, sepse jo të gjithë e dinë.

Po, ne përpiqemi të ruajmë komunikim të vazhdueshëm për të marrë perceptimin sesi na shohin gazetarët.

Para disa ditësh isha në një panel me zonjën Zhupa, në Europe House, ku kishte një numër të konsiderueshëm të gazetarëve kryesorë. Një nga njerëzit, për të cilin kam respekt profesional, është drejtoresha e rrjetit investigativ “BIRN”, e cila, në përgjigje të komentit të zonjës Zhupa, por edhe të përgjigjes sime për kontrollin e informacionit, tha: “Jo, MIA edhe ligjërisht e ka të pamundur të përgjigjet për institucionet e tjera. Përveç se nuk është e sanksionuar gjëkund në ligj, MIA nuk e ka këtë të drejtë të përgjigjet, ndaj do të ishte një diskutim i kotë të vazhdoni të flisni për kontrole”.

Ne jemi të hapur për të vijuar ciklin e takimeve periodike me gazetarët, për të kuptuar se çfarë duhet të përmirësojmë.

Për sa i përket produktit, që ju e keni të paqartë, e theksova që MIA është një mekanizëm i informimit publik, ku përfshihen shumë elemente, ndër të cilat janë edhe

produktet që përmenda. Pra, janë produksioni për mjetet e komunikimit *online*, marrëdhëniet e përditshme me gazetarët që materializohen edhe në kërkesat me shkrim që gazetarët sjellin si pyetje e përgjigje.

Në faqen tonë zyrtare, në zbatim të ligjit, ka edhe një regjistër publik ku është e shënuar data e mbërritjes së kërkesës, data e kthimit të përgjigjes për gazetarët. Pra, ju mund ta verifikoni lehtësisht mesataren e kthimit të përgjigjes, që është 3 deri në 4 ditë, ndërkohë që ligji e parashikon që brenda 10 ditëve mund të kthehet përgjigje për një kërkesë. Pra, mesatarja e kthimit të përgjigjes që përmenda, 3 deri në 4 ditë kohë, është si rrjedhojë e këtij ridimensionimi dhe energjisë së re që ka ardhur në aspektin e komunikimit ngritja e Agjencisë për Medien dhe Informim.

Për produktet tona, zonja Nebijaj, mund të flasim gjatë gjithë ditës, nëse kemi kohë të mjaftueshme, vetëm më pyesni.

Faleminderit!

**Evis Kushi** – Zoti Hysi, edhe një herë faleminderit për të gjitha shpjegimet!

E përmendët shumë herë zonjën Zhupa, por fatkeqësisht nuk e kemi këtu në mbledhje. Jam e bindur se edhe ajo do të kishte dashur t'u jepte përgjigje këtyre diskutimeve dhe çështjeve që ju ngritët, por, me sa duket, nuk e thyen dot vendimin e grupit të saj parlamentar për ta bojkotuar mbledhjen.

Falënderoj zotin Hysi dhe kolegët!

Këtu e mbyllim edhe këtë pikë të rendit të ditës për të vijuar pas pak me çështjen tjetër: diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024” me ministren e Kulturës, zonjën Elva Margariti.

Të nderuar kolegë, mos u largoni, do të bëjmë një pushim shumë të shkurtër dhe do të vijojmë menjëherë mbledhjen.

## **MBYLLET MBLEDHJA**



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*

#### **PROCESVERBAL**

Tiranë, më 13.11.2023, ora 15:30

#### **Drejton mbledhjen:**

**Evis Kushi – nënkryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 7 nëntor 2023.
- Diskutimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024” me ministren e Kulturës, zonjën Elva Margariti.

#### **Marrin pjesë:**

Evis Kushi, Lindita Buxheli, Petro Koçi, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Ilir Topi, Ilir Metaj, Blerina Gjylameti, Florenc Spaho, Dasantila Tahiraj, Enslemvera Zake, Meri Markiçi, Ina Zhupa, Eralda Bano, Merita Bakiu, Kastriot Piroli, Orjela Nebijaj dhe Ismet Beqiraj (zëvendësues).

#### **Mungojnë:**

Flutura Açka, Agron Gjekmarkaj dhe Andia Ulliri.

#### **Të ftuar:**

Elva Margariti – ministre e Kulturës,

Zerina Bruçi – sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Kulturës.

## HAPET MBLEDHJA

**Evis Kushi** – Të nderuar kolegë, fillojmë mbledhjen e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Verifikojmë kuorumin. Të pranishëm kemi: zonjën Eralda Tase Bano, zonjën Orjela Nebijaj, zotin Ismet Beqiraj, zonjën Meri Makiçi, zotin Eduard Ndreca, zonjën Merita Bakiu, zotin Kastriot Piroli, zotin Petro Koçi, zonjën Dasantila Tahiraj, zonjën Enslemvera Zake, zonjën Lindita Buxheli, zonjën Teuta Ramaj dhe zotin Florenc Spaho. Pra, e kemi kuorumin.

Mbledhjen e deklaroj të hapur.

Në rend të ditës kemi dy çështje.

Së pari, miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 7 nëntor 2023.

Si çështje të dytë kemi seancë dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024” me ministren e Kulturës, zonjën Elva Margariti.

Për sa i takon pikës së parë të rendit të ditës, miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 07.11.2023, a jeni të gjithë dakord, kolegë? Dakord.

Miratohet.

Vijojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, me diskutimin në parim të buxhetit për vitin 2024, me ministren e Kulturës, zonjën Elva Margariti.

Të ftuar në këtë mbledhje kemi, gjithashtu, edhe sekretaren e Përgjithshme të Ministrisë së Kulturës, zonjën Zerina Bruçi.

Fjala menjëherë për ministren e Kulturës, zonjën Elva Margariti, për të bërë një prezantim të përgjithshëm të projektbuxhetit për vitin 2024 dhe, më pas, do të vazhdojmë me seancën e pyetjeve dhe diskutimeve nga kolegët.

Zonja Margariti, mirë se keni ardhur në komision!

Fjala për ju.

**Elva Margariti** – Shumë faleminderit!

Besoj se dëgjohem mirë?

**Evis Kushi** – Dëgjoheni shumë mirë.

**Elva Margariti** – Të nderuar deputetë,

Sot do të diskutojmë së bashku projektbuxhetin e vitit 2024, ndërsa po përmbyllim një vit shumë të suksesshëm në fushën e kulturës, ku të gjithë do të kujtojmë se në vitin 2023 ishte viti i Festivalit mbarëkombëtar Folklorik të Gjirokastrës, që solli në skenën e rijetësuar

tashmë të kalasë një numër tejet i madh performuesish, kanë qenë pothuajse 1700 të tillë, të cilët na u bashkuan në këtë festival dhe 400 prej tyre, do të doja ta specifikoj, ishin artistë, të cilët vinin nga jashtë vendit. Kemi pasur një numër tejet të lartë spektatorësh, mbi 20 mijë spektatorë në këtë festival, që ndoqën 40 koncerte dhe mbi 100 aktivitete. Numri i turistëve të huaj ishte po ashtu i lartë.

Pse po e nis pikërisht me këtë festival? Sepse Festivali mbarëkombëtar Folklorik i Gjirokastrës besoj se është një emërues i shumë punëve të bëra nga Ministria e Kulturës, ku në qendër nuk janë vetëm aktivitetet artistike dhe mbështetje e artistëve, por, gjithashtu, është edhe rigjallërimi i aseteve të rëndësishme të trashëgimisë kulturore, në këtë rast të kalasë, por edhe të një qyteti të mbrojtur nga UNESCO.

Ne kemi qenë të gjithë dëshmitarë të kësaj jehone të një pune të nisur më shumë se një vit më parë që u rikthye pas 8 vjetëve mungesë, një jehonë që edhe në mediet më të mëdha të botës ka marrë vëmendjen e duhur. Pra, me plot gojën mund të themi se 2023-shi ishte viti i turizmit kulturor. Fakti i këtij emërimi, po themi, të turizmit kulturor është patjetër edhe një qasje që e shikojmë edhe në numra.

Institucionet dhe qendrat e trashëgimisë kulturore gjatë muajve janar-tetor të 2023-shit janë vizituar nga 914 mijë e 877 vizitorë. Sjell në vëmendjen tuaj se rekordi i turistëve në trashëgiminë kulturore ka qenë viti 2019 me 1 milion vizitorë në këto site. Pra, duke marrë parasysh se statistikën që po paraqes janë deri në muajin tetor të këtij viti, ne jemi besimplotë se do ta tejkalojmë këtë shifër të vitit 2019, që ka qenë viti më i suksesshëm dhe që më pas u pasua në ulje të numrit për shkak, siç e dimë, të pandemisë.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022 llogaritet një rritje prej rreth 45,29% e numrit të vizitorëve dhe në krahasim me vitin 2021, rritja është edhe më e madhe në shifrën 139%.

Patjetër këto janë reflektuar edhe në të ardhura dhe të ardhurat për vitin 2023 për institucionet dhe qendrat e trashëgimisë kulturore gjatë muajve janar-tetor kanë gjeneruar një total, të rumbullakosur, në 318 milionë lekë nga vizitorët. Ndërsa për vitin 2022 kjo shifër arrin në rreth 225 milionë lekë, që do të thotë se të ardhurat vazhdojnë të jenë në rritje në sitet tona dhe rritja është afro 41%. Siç e thashë, jam e bindur që do të kalojmë rekordin e vitit 2019 prej 1 milion vizitorësh dhe, patjetër, kjo do të jetë një vazhdimësi e punës, siç kemi bërë në projeksionin e aktiviteteve, restaurimeve, mirëmbajtjeve, rijetësimit, që ka sjellë edhe në vazhdimësi këtë numër të rritur të vizitorëve, por edhe të aktiviteteve në sitet tona të trashëgimisë.

Patjetër, viti 2023 ka qenë edhe viti i rritjes së pagave, çka ka dhënë edhe frytet e saj, siç e kemi vënë re edhe në cilësitë e performancave të ndryshme në sektorin e arteve dhe kulturës, në rastin e aktiviteteve artistike dhe në rritjen e numrit të spektatorëve. Do të ndalesha shkurt këtu për të thënë se deri tani në muajin nëntor institucionet tona të artit kanë dhënë gati 900 shfaqje, pra 890 të tilla, dhe një numër prej 309 mijë spektatorësh, ndërkohë që në vitin 2022 kemi pasur 621 shfaqje gjatë gjithë vitit dhe numri i spektatorëve ka qenë 85 mijë. Pra, siç mund ta shikoni, numrat janë në një progresion shumë të lartë në rritje.

Gjithashtu, duke iu referuar edhe institucioneve të artit, pjesës buxhetore, për sa u përket numrit të biletave të shitura për periudhën janar-tetor, në vitin 2022 ka qenë 31 mijë e 79, ndërsa në vitin 2023 ka qenë 58 mijë e 104 bileta. Pra, kemi 87% më shumë bileta të shitura përgjatë vitit 2023.

Patjetër, projektbuxheti i vitit 2024 parashikon vijimësinë e kësaj pune për të çuar përpara zbatimin e nismave madhore, ruajtjen e trendit në rritje në vizitueshmërinë e siteve të trashëgimisë kulturore, si dhe nismat që lidhen me kalendarët artistikë apo me aktivitete të shpërndara në të gjithë territorin kombëtar, për të sjellë po njëjloj një rritje të vizitueshmërisë dhe automatikisht edhe të buxheteve të dedikuara pranë institucioneve tona.

Buxheti i vitit 2024 i paraqitur nga Ministria e Kulturës pritet të jetë në masën 4 miliardë e 463 milionë e 56 mijë lekë, që përkthehet në një rritje prej 12% më shumë, krahasuar me vitin që po lemë pas. Patjetër, rritja e buxhetit dhe i gjithë prioriteti qeveritar për të sjellë edhe një herë më shumë në vëmendje institucionet, që punojnë pranë administratës, zënë një peshë të madhe.

Në rastin e Ministrisë së Kulturës është 29% rritja e buxhetit të dedikuar për pagat në krahasim me vitin 2023, por edhe shpenzimet kapitale me pothuajse 30% krahasuar me vitin 2023.

Do të riktheja në kujtesën tuaj politikën dhe nismat për mbështetjen e profesionistëve, të cilët punojnë pranë Ministrisë së Kulturës, gjë që e kemi bërë edhe më herët. Besoj se të gjithë e mbajnë mend premtimin e mbajtur për rritjen e pagave të artistëve tanë të Teatrit të Operës dhe Baletit dhe Ansamblit Popullor, që u pasua, po këtë vit, me vazhdimësinë e rritjes së pagave, kësaj radhe duke pasur në vëmendje rritjen e mbështetjes ekonomike për të gjithë sektorin mbështetës, për teknikët, pra çdo gjë që lidhet me pjesën më administrative dhe teknike për mbarëvajtjen e institucionit.

Pagat janë parashikuar në vlerën 1,44 miliardë lekë ose 32% e buxhetit total, por ajo çfarë dua të vendos në vëmendjen tuaj janë investimet, 2,22% miliardë lekë, që në totalin e

buxhetit të dedikuar për vitin 2024 zënë 50% të buxhetit. Pra, investimet dhe nismat madhore vazhdojnë të jenë në fokusin e Ministrisë së Kulturës. Në vitet e fundit kjo ministri konsiderohet gjithmonë e më tepër si pjesë e kantierëve të mëdha, për t'i ridhënë jo vetëm rëndësi siteve të trashëgimisë kulturore, por, mbi të gjitha, edhe atyre institucioneve të artit ose rikualifikimeve të mëdha, që kanë treguar në vitet e mëparshme një mungesë të hapësirave për performanca.

Programi “Për planifikim, menaxhim dhe administrim” për vitin 2024 parashikohet, siç thashë, me një rritje rreth 12%, krahasuar me vitin 2023, ndërsa kapitulli “Art dhe kulturë” me 3,34 miliardë për vitin 2024 dhe është po me rritje 12%, krahasuar me 2023-shin.

Rritjen më të madhe e kemi në kapitullin “Trashëgimia kulturore dhe muzetë” me 916 milionë lekë për vitin 2024 me një rritje prej 21%.

Në vijim do të tregoj se cilat janë projektet madhore dhe pesha që fillojnë dhe marrin këto projekte me rritjen e buxhetit të dedikuar tashmë pikërisht në këtë kapitull, sepse deri në vitin 2023 projektet madhore të lidhura ngushtësisht me hapësirën e artit dhe kulturës kanë mbajtur edhe peshën e rritjes në investime kapitale në atë kapitull.

Ne i kemi shumë të qarta objektivat tona dhe synojmë patjetër të mbështetemi te vlerat më të mira të së shkuarës, por duke parë edhe të gjithë trendin e zhvillimeve që ka sektori për sa i përket përfshirjes së të rinjve, përfshirjen e sa më shumë të aspekteve digjitale dhe të inovacionit dhe, patjetër, me ndërthurjen e elementeve të trashëgimisë kulturore të vendeve të kujtesës dhe ofrimin e vendeve të reja të punës, duke ndjekur politika të qarta, që lidhen me fëmijët dhe të rinjtë, lidhen me trashëgiminë kulturore dhe me komunitetin si pjesë e saj, pra asnjëherë si rikualifikim i një ambienti ose i një objekti në vetvete, promovimi i artit dhe mbështetja e komunitetit artistik, si dhe diplomacia kulturore. Kjo e fundit, besoj se të gjithë e kemi vënë re në 2 vjetët e fundit, sidomos në një nga nismat më të suksesshme të qeverisë shqiptare “Javët kulturore ndërkombëtare”, ka sjellë një impakt jo vetëm në zhvillimin dhe në mbështetjen e disa sektorëve dhe nënsektorëve të kulturës, por mbi të gjitha ka sjellë një ekonomi shtesë në të gjitha qytetet, ku zhvillohen këto aktivitete. Duket, ndoshta, si një ëndërr e largët kur kemi premtuar nisjen e kantierit të Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë. Tashmë është në kantier për çdokënd, do të afrohet pranë zonës së ish-Gardës, që do të shikojë se si kemi avancuar në një kohë shumë të shpejtë përgjatë vitit 2023 me këtë hapësirë, që është pjesë e një studimi më të gjerë, të një poli kulturor që i shtohet Tiranës ku, siç thashë, politikat për fëmijët dhe të rinjtë qëndrojnë në bazë të saj, duke u rikthyer një vëmendje tjetër jo vetëm performancave të lidhura me to, por, mbi të gjitha, edhe mundësive



e reja të punësimit. Është një projekt ambicioz dhe ka buxhet të dedikuar për të gjitha vitet e implementimit, që është afro 1 miliard lekë.

Për vitin 2023 mbështetja e dedikuar është rreth 350 milionë lekë dhe vazhdojmë për vitin 2024 me 480 milionë lekë.

Ndërkohë, dua të ndalem pak te godina historike e Teatrit të Kukullave, pasi gjithmonë ekziston një pikëpyetje sa herë që themi se po ndërtojmë Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrin e ri të Kukullave në të. Atëherë, Teatri aktual i Kukullave patjetër është në fazën e rikonstruksionit. Godina do t'i rikthehet historikut të rrënjëve të saj, duke pasur edhe hapësirën e muzeut të vetë historisë së godinës dhe do të kthehet në një qendër kulturore multifunksionale fiks në qendër të Tiranës. Ky është një investim që po kryhet falë programit të *"You for culture"*, duke u bërë pjesë e një poli shumë të rëndësishëm, sidomos në qendër, në sheshin e qytetit, duke e lidhur, njëkohësisht, edhe me investime të tjera të bëra bashkërisht me donatorë, siç është edhe ish-Piramida, që tashmë ka filluar të shërbejë si një qendër gjigande inovacioni dedikuar të rinjve.

Jo më kot i lidha të dyja këto projekte bashkë, për t'ju treguar qartazi se projektet e nisura dhe ato që janë në vazhdimësi janë pjesë e politikave, prioriteteve të mirëmenduara, ku gjithmonë Ministria e Kulturës ka në fokusin e saj ndërveprimin me donatorët, duke parë një mundësi të mirë në krijimin e buxheteve të përbashkëta, si një aset për të çuar përpara prioritetet dhe për të mos u ndalur asnjëherë vetëm në buxhetin e dedikuar të Ministrisë së Kulturës, ashtu si në rastin e Piramidës, që të gjithë e dimë, është një bashkëfinancim i qeverisë shqiptare, i Bashkisë së Tiranë, dhe i partnerit tonë Fondit Amerikano-Shqiptar për Zhvillim.

Po në shërbim të të rinjve, të artistëve të së ardhmes dhe të të gjithë komunitetit artistik të gjithë e dimë se përmbyllëm me sukses, përruam një prej projekteve më ambicioze, që është rikonstruksioni i sallës së Akademisë së Arteve, edhe ky një tjetër bashkëpunim me donatorë, në këtë rast një investim prej 3,7 milionë eurosh që vjen i ndarë në 2 milionë euro nga qeveria shqiptare dhe 1,7 të tjera nga TAP-i, nga fondi i përgjegjësive të tyre sociale.

Paralelisht vazhdojmë me punë në Galerinë Kombëtare të Arteve, që do të shndërrohet në një muze të arteve të bukura. Ky projekt i nisur në vitin 2021, që pritet të finalizohet në fund të vitit 2024, është një tjetër investim prej afro 1 miliard lekësh, që është parashikuar të vazhdojë në vitin 2024.

Ndonëse në rikonstruksionin e Galerisë Kombëtare të Arteve mund të mendojnë të gjithë sikur flitet vetëm për një restaurim, dua të ndalem edhe këtu, por fakti i hapësirave të reja të dedikuara dhe sidomos i hapësirave jo vetëm për ruajtjen, por edhe për aspektin e digjitalizimit, konservimit dhe promovimit të artefakteve, që ndodhen pranë Galerisë Kombëtare të Arteve shton një pjesë tjetër infrastrukture dhe një pjesë tjetër qasjeje për punësimin e të rinjve dhe të komunitetit.

Për vitin 2023 mbështetja e dedikuar ishte afro 409 milionë lekë dhe vazhdojmë punën e nisur në vitin 2024 me një tjetër buxhet prej 300 milionë lekësh.

Një tjetër projekt në vazhdim është Teatri i ri Kombëtar, që bashkë me Galerinë Kombëtare të Arteve, me muzeun “Besa”, afër Kalasë së Tiranës, ashtu edhe me Muzeun Etnografik të Tiranës te Sarajet, së bashku me Bashkinë e Tiranës, do të krijojnë një aks dhe një pol gravitacional shumë të rëndësishëm për jetën kulturore jo vetëm për kryeqytetin, por për të gjithë Shqipërinë. Vlera totale për ndërtimin e Teatrit është vlera më e madhe që e mbulon Ministria e Kulturës dhe është afro 4,8 miliardë lekë dhe për vitin 2024 buxheti i parashikuar, sipas grafikut të punimeve, do të jetë 820 milionë lekë dhe do të fillojnë të gjitha procedurat dhe implementimi me 275 milionë lekë për pajisje mobilimi, pra për çdo element teknik, skenik, që lidhet me të gjithë pjesën ndërtimore të godinës.

Po ashtu, po krijojmë në Tiranë edhe një tjetër qendër, paksa të harruar do ta quaja, që është Mozaiku i Tiranës. Ka qenë në fokusin tonë këta dy vjetët e fundit, një punë e kryer edhe kjo në një komunitet të gjerë jo vetëm restauratorësh, por edhe arkeologësh, së bashku me Bashkinë e Tiranës, që ka bërë edhe rikualifikimin e zonës përreth. Pra, siç e thashë, gjithmonë mundohemi të koordinojmë dhe të bashkërendojmë si pjesën e punimeve, ashtu edhe të investimeve.

Mozaiku i Tiranës, që tashmë e kemi nxjerrë në dritë, do të kthehet në një tjetër qendër të vogël muzeale dhe me një infopoint për të filluar rrugëtimin drejt promovimit të të gjithë mozaikëve në Shqipëri, sepse mendojmë se kanë një potencial shumë të lartë për një turizëm të dedikuar, një turizëm arkeologjik jep vetëm drejt parqeve, por duke pasur një emërues të përbashkët, atë të promovimit dhe të zbulimit të mozaikëve.

Po ashtu, po krijojmë një tjetër Park të ri Arti, këtu në ish-Kinostudio, në ambientet përreth Ministrisë së Kulturës. Parku i Artit tashmë po merr gjithmonë e më tepër formë dhe po i kthen identitetin artistik kësaj zone, që, në njëfarë mënyre, kishte humbur, duke u rifokusuar vetëm në funksionet e saj rezidenciale dhe duke i rikthyer edhe atë momentin e

glorifikimit po themi të kinematografisë. Pra, bëjnë bashkë elemente të ndryshme të një rikualifikimi urban pune, ku në qendër qëndron komponenti artistik dhe kulturor.

Dua të theksoj këtu që edhe ky projekt madhor filloi si një mbështetje e Bashkimit Europian përmes një granti të dedikuar afro 1 milion euro, për të vazhduar me një fond nga buxheti i shtetit prej afro 140 milionë lekësh.

Dua të ndalem pak, pasi e kemi lënë Tiranën, po themi, me kantierët e saj të mëdhenj, që janë gjithmonë jo vetëm të fokusuar në zhvillimin e kryeqytetit, por të gjitha tematikat që kemi prekur janë hapësira kombëtare të dedikuara për nisma kombëtare ose të lidhura në mënyrë indirekte edhe me pjesë të tjera të territorit dhe të zhvillimit të institucioneve të tjera përmes këtyre investimeve.

Një proces shndërrimi rrënjësor është ai që kemi nisur në Durrës, qytet i cili ka marrë tashmë vëmendjen e Ministrisë së Kulturës, pra jo vetëm të të gjithë qeverisë shqiptare, siç e dimë, me të gjitha investimet madhore, por ne kemi filluar punën që me hartimin e planit të dedikuar pas tërmetit, ku kemi evidentuar jo vetëm godinat e dëmtuara, por edhe mënyrat e rikualifikimit dhe restaurimit të tyre, për t'i sjellë në një funksion më dinamik të lidhura me njëra-tjetrën.

Gjithashtu, kemi hartuar që asokohe, pra në periudhën pas tërmetit, një plan të dedikuar si një plan zhvillimi i zonave të reja rezidenciale dhe të njëjtën filozofi kemi pasur qasjen për zhvillimin e Durrësit, për të vazhduar më pas me planin e menaxhimit të Durrësit, i cili tashmë është miratuar në këshillat tanë kombëtarë dhe është drejt rrugës për miratimin me një vendim të Këshillit të Ministrave.

Ndërkohë, projekti ynë madhor, që ka filluar që në vitin 2023, është fillimi i punimeve në amfiteatrin e Durrësit. Ministria e Kulturës ka përfunduar për vitin 2023 shpronësimin e godinave në zemër të amfiteatrit dhe, njëkohësisht, ka alokuar për vitin 2024 buxhetin e nevojshëm për fillimin e gërmimeve arkeologjike në zonën e amfiteatrit, si dhe rehabilitimin e të gjithë zemrës së kësaj pasurie kulturore. Besoj se ky është një lajm i mirë për të gjithë ata që kanë pritur me dekada për të zbuluar nga afër historinë e vërtetë të Durrësit antik dhe për t'i dhënë jo vetëm amfiteatrit, por të gjithë zonës urbane tejet të ngarkuar me aktivitete sa ekonomike, ashtu edhe turistike, duke e kthyer atë tashmë në një qendër të vërtetë të vizitueshmërisë të turistëve të shtuar, pse jo, edhe gjatë fazës së gërmimeve, që, siç na tregojnë eksperiencat e mira botërore, edhe vetë një gërmim arkeologjik në qiell të hapur krijon kureshtje. Kësisoj, gjatë vitit 2024 dhe gjatë fazës së gërmimeve ne presim të kemi një numër të shtuar të vizitorëve dhe që këto ndërhyrje të

ndodhin pa e ndalur vizitueshmërinë e sitit, përkundrazi, duke e bërë atë edhe më atraktive për të shtuar numrin e vizitorëve.

Patjetër, ky është një nga momentet e rëndësishme të fillimit të këtyre punimeve, por nuk do të jetë i vetmi që do të ndërmerret në Durrës përgjatë vitit 2024. Përveç faktit që buxheti i shtetit tashmë fillon të mbështesë edhe Bashkinë Durrës, me rikualifikim e restaurim të teatrit “Aleksandër Moisiu”, jo shumë larg nga zona e amfiteatrit dhe në qendrën e qytetit do të ketë një buxhet të dedikuar, duke qenë se është edhe monument kulture, po edhe sepse në bazamentin e saj ka rrënoja arkeologjike. Pra, edhe një herë tjetër, fillojmë dhe mbështesim komponentë të ndryshëm brenda një investimi, duke mos u ndalur asnjëherë vetëm në një qasje.

Një tjetër projekt në vazhdim, sërish me donatorë, është ai TIK-Durrës. Vetëm pak metra më larg, në bulevardin “Epidamn”, fillon puna menjëherë pas miratimit që i kemi dhënë projektit të detajuar të restaurimit të bulevardit kryesor të Durrësit, duke ndjekur modelet e mira të qendrave historike në Vlorë, të Pazarit të Gjirokastrës, të Krujës, të Korçës. Nën të njëjtën formulë dhe me të njëjtin partner, me Fondacionin Amerikano-Shqiptar për Zhvillim, fillojmë punën tashmë me një marrëveshje trepalëshe me Bashkinë e Durrësit për t’i rikthyer dinjitetin jo vetëm bulevardit, por, mbi të gjitha, për t’u dhënë akoma më shumë mundësi ekonomike qytetarëve që jetojnë në atë zonë dhe që kanë bizneset ose banesat e tyre.

Viti 2024, besoj se me plot gojën mund të quhet viti kur do të kemi vërtet preken e parë të të gjithë kësaj pune, të paktën dyvjeçare, që kemi bërë mbi Durrësin, ndaj jam vërtet krenare që në këtë rrugëtim nuk kemi qenë asnjëherë të vetëm, por kemi qenë gjithmonë të mbështetur si nga partnerë të huaj, ashtu edhe nga pushteti vendor. Ama ka qenë, gjithashtu, prioritet i qeverisë që ne kemi arritur ta koordinojmë me të gjitha ndërhyrjet e tjera që po zhvillohen në vend.

Do të thosha që bonusi i rijetëzimit, që është një tjetër skemë kombëtare, rivjen për vitin 2024, patjetër me buxhete të dedikuara. Ne e filluam këtë nismë të qeverisë shqiptare në vitin 2022. Në vitin e parë patëm 40 përfitues me projekte që preknin në numër të lartë edhe zonat UNESCO, si Berati dhe Gjirokastra, por pa u ndalur vetëm në këto dy qytete, po edhe në Korçë, në Shkodër, në Përmet, në Pogradec, si dhe në Krujë, ku pati një numër shumë të lartë të aplikuesve. Për herë të parë Kruja fillon dhe kupton rëndësinë e pasjes një kala të banuar dhe të qytetarëve që bëhen bashkë për të filluar investimin në banesat e tyre.

Në thirrjen e dytë të vitit 2023, ne kemi shpallur 57 fitues. Pra, arrijmë nga 40 në 57, duke e shtrirë hartën e përfituesve tashmë edhe në Elbasan, edhe në Kukës, edhe në Bulqizë,

edhe në Konispol, në Qeparo dhe Himarë, që u shtohen qytetet e mëparshme, që i përmenda, të cilat lajmin e mirë të këtij programi dhe të kësaj nisme, të kësaj mbështetjeje, e kishin përcjellë në vazhdimësi brenda për brenda qyteteve të tyre.

Çfarë ka të veçantë ky program? Është pikërisht fakti që forma e investimit është një bashkëfinancim i buxhetit të shtetit me qytetarët, pra pjesa e financimit privat apo financimit tjetër, që i bashkohet ministrisë, nuk është tashmë një donator shqiptar ose i huaj, por janë vetë qytetarët, të cilët bashkëfinancojnë me qeverinë shqiptare nëpërmjet Ministrisë së Kulturës për restaurimin dhe rijetëzimin e banesave të tyre në qendër historike. Madje, është shumë domethënës trendi i buxheteve se si kanë kaluar nga viti 2022 në 2023, sepse rritja e financimit publik është rritur vërtet me 50%. Në vitin 2022 buxheti i shtetit alokoi 100 milionë lekë për ta mbështetur këtë skemë kombëtare, për ta shtuar atë në 150 milionë lekë në vitin 2023, por tregues domethënës është rritja e bashkëfinancimit privat, që shkon në 153%. Pra, nga 45 milionë lekë, që ishte në vitin 2022, ajo çfarë dhanë qytetarët, të cilët ishin bashkëfinancues të programit, këtë vit janë 137 milionë lekë ato të cilat bashkinvestohen nga qytetarët. Pra, është pothuajse e njëjta shifër si në buxhetin e shtetit. Nëse shteti po vendos 150 milionë lekë përgjatë vitit 2023, ata po vendosin 137 milionë lekë.

Mendoj se është një moment i veçantë për ta theksuar. Ky moment i shtuar i bashkëveprimit shtet-qytetar është patjetër një dëshmi e besimit të qytetarëve te nismat madhore të qeverisë shqiptare, duke kuptuar së afërmi atë çfarë ne synojmë, që është një zhvillim ekonomik i qëndrueshëm, gjithmonë ashtu siç bën Ministria e Kulturës, duke ndërmarrë nisma kombëtare.

Gjatë vitit 2023 vazhduam një tjetër nismë të nisur gjatë vitit 2022, që është “Art në hapësirat publike”, që, po ashtu, është një nismë e qeverisë, e shtrirë edhe kjo në territorin kombëtar, ku u akordua një fond prej 200 milionë lekësh. Nisma patjetër synonte të ndryshonte imazhin e hapësirave publike ose të atyre ndërhyrjeve kryesisht në infrastrukturë, që lidhen me rreth-rrotullimet apo me hapësira shkëmbim lëvizjesh, që në plan të parë duken si të parëndësishme, por që, në të vërtetë, duke marrë parasysh edhe nisma të tjera ose raste të tjera reference në botë, gjithmonë komunitetet fillojnë dhe ndahen nga territori ku jetojnë dhe ndiejnë përkatësitë.

Ne kemi bërë bashkë, përveç artistëve, edhe plot profesionistë të fushave të ndryshme, për të sjellë projekte për rikualifikimin e hapësirave të tyre.

Më vjen mirë të them që në vitin e parë, kur hapëm thirrjen, kemi pasur 132 projekte kandidate nga e gjithë bota. Pra, ka qenë një thirrje ndërkombëtare ajo që bëmë në këtë

konkurs, ndërkohë që 72 ishin artistë nga Shqipëria. Pjesëmarrësit kanë qenë nga të gjitha kontinentet.

Pra, rëndësia e diplomacisë kulturore është për t'u theksuar, pasi këta artistë që kanë kthyer vëmendjen për të shprehur artin e tyre në Shqipëri janë pjesë jo e rastësishme apo fatlume, siç shpeshherë dëgjojmë mbi ndërveprimin e tyre.

Kemi mbaruar tri vepra arti, dy janë në proces, dy të tjera në proces drejt përfundimit, ndërkohë që dy të tjera duke pasur një ecuri të mirë. Pra, gjithnjë e më tepër i rikthejmë vëmendjen dinjitetit të artistëve jo vetëm në performancat e tyre në ekspozita, por edhe duke dhënë një vepër arti e cila kthehet më shumë se një ekspozitë apo një vepër e ekspozuar në një muze.

Po kaloj tani te pjesa që i përket trashëgimisë kulturore.

Kemi pasur një sërë projektesh prioritare, që lidhen kryesisht me pjesën e restaurimit dhe mirëmbajtjes. Do të ndalesha këtu pak mbi ato projekte që janë financuar nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, që ndjek një listë prioritare objektesh, përgjithësisht në emergjencë ose në nevojë imediate për ndërhyrje. Kemi filluar projektet e restaurimit në kishën e fshatit Kozarë, në kishën në Shelcan, në Postenan, në Lunxhëri, si dhe po bëjmë restaurimin dhe konservimin e kullave dhe kurtinave në kalanë e Beratit.

Buxheti i vitit 2023 do të vazhdojë edhe në vitin 2024, sepse disa prej këtyre projekteve vijojnë edhe përgjatë vitit 2024 ose të tjera projekte përgjatë vitit 2024 shtohen për të pasur pak a shumë të njëjtën shifër: 42 milionë lekë për vitin 2023 dhe 41 milionë lekë për vitin 2024.

Ndërkohë, edhe drejtoritë rajonale kanë vazhduar me planin e tyre, që lidhet me mirëmbajtjen dhe restaurimeve në vijim. Kemi pasur një numër të lartë, sidomos në zonën e Finiqit, si, për shembull, kisha e Shën Mërisë, kisha e Shën Mëhillit në fshatin Kostarë, Shën Kollit i Mesopotamit dhe plot ndërhyrje të tjera që lidhen me aspektet e arkeologjisë. Për projekte madhore në fushën e trashëgimisë kulturore kemi çuar jo vetëm buxhetet tona të dedikuara të ministrisë apo të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë, apo drejtorive rajonale në terren, por edhe me donatorë ose me fonde të adresuara shpeshherë nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Këtu të gjithë e kemi parë punën që është bërë në Sheshin e Çerçizit apo në Muzeun Etnografik në Berat, ashtu siç kemi vazhduar punimet në Xhaminë e Plumbit. Janë një sërë donatorësh apo ndërveprimesh si nga Banka Botërore, ashtu edhe nga qeveria turke.

Totali i të gjitha projekteve të mbledhura në këtë lëm shkron në afro 2,2 miliardë lekë.

Nëse ju kujtohet, në fillim të fjalës sime citova që në buxhetin total të vitit 2024 kemi 2,2 miliardë lekë, që është gati 50% e buxhetit total të Ministrisë që shkon drejt investimeve. E njëjta shifër është ajo që arrijmë të kemi falë mbështetjes dhe koordinimit nëpërmjet donatorëve, duke shpërndarë kështu prekjën e ruajtjes së trashëgimisë në të gjithë territorin, duke mirëmenaxhuar buxhetet e shtetit dhe ato me donatorët.

Përgjatë vitit 2023, një tjetër program i rëndësishëm për ringritjen dhe rijetësimin e monumenteve të dëmtuara nga tërmeti, ku tashmë të gjithë kemi filluar të shikojmë punët e mira të bëra së bashku, është programi EU4Culture, që është një nga programet më të mëdha që Delegacioni i Bashkimit Europian ka mbështetur në fushën e kulturës. Është e para herë që një shifër xheneroze prej rreth 40 milionë eurosh vjen për ruajtjen dhe rimëkëmbjen e monumenteve post-tërmet. Kemi përfunduar dhe ua kemi rikthyer tashmë komuniteteve kishën e kepit të Rodonit dhe kishën e Rubikut, ashtu siç kemi përfunduar restaurimin e mozaikut të Muzeut Historik Kombëtar.

Gjithashtu, Kulla Veneciane në Durrës, nga një hapësirë për shumë kohë e kthyer në një kafeteri dhe më pas e abandonuar, tashmë është një qendër informacioni digjitale, ku të gjithë vizitorët kanë mundësinë të njohin jo vetëm pasuritë e Durrësit, po edhe të zonave përreth nëpërmjet aplikacioneve digjitale përmes audio-guidave, duke sjellë kështu edhe një herë tjetër atë çfarë kemi si prioritet ne, si ministri, ndërthurjen e shumë komponentëve për rehabilitimin e restaurimit; edhe në këtë rast me një projekt me donatorë.

Jemi në përfundimin e Muzeut Etnografik të Krujës. Presim të kemi zhvillime shumë të mira deri në fund të vitit, pasi i gjithë restaurimi ka mbaruar dhe tashmë jemi në fazën e implementimit digjital me marrjen e informacioneve me *QR Code* apo me mënyra të tjera inovative, për ta kthyer gjithmonë sa më digjital. E njëjta gjë ndodh me Muzeun Etnografik të Kavajës, ku një tjetër hapësirë kjo e harruar dhe që do t'i rikthehet qytetit, për të vazhduar, po kështu, me Hamamin në Durrësit, me ish-Teatrin e Kukullave në qendër të Tiranës dhe me Kalanë e Bashtovës.

Viti 2024 pritet të kulmojë, gjithashtu, me projekte të tjera madhore në fushën e muzeve. Këtu do të ndalesha fillimisht në Muzeun Historik Kombëtar, i cili vjen edhe kësaj radhe si një ndërveprim i qeverisë shqiptare me Delegacionin Europian, ku ky i fundit, falë programit EU4Culture, ka investuar deri tani pothuajse 1,2 milionë euro për hartimin e plotë të të gjithë projektit, që vjen jo vetëm si konsolidim post-tërmet, po edhe totalisht një projekt i ri me një linjë të re muzeore dhe me të gjitha nevojat e qasjes, siç thashë, digjitale, po edhe të ruajtjes së kujtesës. Projekti ka përfunduar të gjitha miratimet e tij dhe ne shumë shpejt do

të fillojmë edhe fazë të tjera të konsultimit publik, pasi linja muzeore ndjek, po themi, një proces tjetër të dedikuar, por, ndërkohë, jemi gati për sa i përket investimit për konsolidimin dhe fillimin e hapësirave të reja. Ky do të jetë një tjetër projekt që bashkëfinancohet nga qeveria shqiptare dhe donatorët. Për momentin, donatori pritet të financojë rreth 6,4 milionë euro për zbatimin e projektit, e cila mund të variojë në bazë të ecurisë së projekteve të tjera, pjesë e paketës së madhe. Ndërsa pjesa e mbetur, afro 20 milionë euro, do të mbështetet në faza nga qeveria shqiptare.

Ministria e Kulturës për vitin 2024, për fillimin e punës me bashkëfinancim ka akorduar 120 milionë lekë për fillimin e punimeve në Muzeun Historik Kombëtar. Pra, siç thashë, viti 2024 na gjen me ecuri të rëndësishme të projekteve që kemi filluar t'i hartojmë, ose në bashkëkoordinim me donatorët, pothuajse dy vjet më parë.

Përgjatë vitit 2024 një tjetër punë që do të konkretizohet është edhe puna e nisur për ngritjen e muzeut kombëtar “Besa”. Një tjetër konkurs ndërkombëtar, i cili ka dhënë tashmë frytet e tij. Pas ardhjes së 5 studiove shumë prestigjioze nga vende të ndryshme të botës, fituesi tashmë është në fazën e hartimit të projektit. Projekti do të zgjasë përgjatë vitit 2023 deri në vitin 2024. Pra, kemi buxhet të dedikuar edhe për vitin 2024 dhe zbatimin total i të gjithë projektit është vlerësuar në fazën e paraqitjes rreth 624 milionë lekë. Duke marrë parasysh temën që prek ky muze, që është tema e besës së shqiptarëve, tema e bashkëjetesës, si dhe duke qenë se në këtë hapësirë të re në qendër të Tiranës presim të kemi një qendër vërtet për dialog, patjetër që do të vazhdojmë edhe përgjatë vitit 2024 të shikojmë mundësinë e ndërveprimit edhe me donatorët, për të pasur gjithmonë mundësinë e bashkërendimit të investimit jo vetëm me buxhetin e shtetit, por edhe me buxhet të huaj, për ta sjellë në ato nivele bashkëkohore, muzeale, siç ka të drejtën dhe dinjitetin të qëndrojë ky muze.

Për herë të parë, si një nismë e ndërmarrë së fundi edhe në kuadrin e përgatitjeve të ditëve të arbëresheve, Ministria e Kulturës ka nisur punën për paraqitjen e projektit të Shtëpisë së Arbëreshëve. Për këtë kemi caktuar një buxhet të dedikuar, për hartimin e projektit, duke ndjekur praktikën e mirë të deritanishme, siç e kemi bërë edhe me muzeun “Besa”. Prandaj, për vitin 2024 kemi planifikuar një buxhet të dedikuar për Shtëpinë Arbëreshëve, një pol ri i kulturor në Krujë. Duke parë numrin e lartë të vizitorëve në qendrën muzeore Krujë, ku është muzeu i Skënderbeut dhe në muzeun etnografik, si dhe duke parë numrin e lartë të aplikimeve për bonusin e rjetësimit, në një studim që i kemi bërë impaktit të turizmit kulturor dhe zhvillimit të kalasë, na ka rezultuar e volitshme për të pasur një tjetër



pikë ndalese, e cila do të sillte edhe mirëmbajtjen e kalasë, por edhe më shumë të ardhura në buxhetin e Ministrisë së Kulturës.

Gjithashtu, dua të shtoj këtu një tjetër muze që lidhet, në një farë mënyre, me kujtesën dhe me vlerat e shqiptarisë që është Muzeu Hebraik në Vlorë. Muzeu Hebraik në Vlorë është i pari në llojin e vet, do të fillojë punën menjëherë në vitin 2024. Edhe këtu kemi pasur një bashkëfinancim me partnerit tonë Fondin Amerikan Shqiptar për Zhvillim, i cili në mbledhjen e fundit të tetorit ka akorduar vlerën e plotë për implementimin e projektit rreth 6 milionë dollarë, dhe puna fillon menjëherë në vitin 2024. Po ashtu, viti 2024 do të gjejë Butrintin me ecurinë e projektit tashmë fitues të studiues prestigjioze *Kengo Kuma Associates*. Në Butrin, ku ndryshe nga të gjitha legjendat urbane që kemi dëgjuar së fundi, nuk do të ketë as hotele dhe as kazino, por do të ketë një portë ftuese e denjë për një pasuri UNESCO. Projekti tashmë i financuar kap vlerën e 400 mijë dollarëve, implementimi i gjithë këtij projekti pritet të kapë vlerën 4 milionë dollarë.

Së fundi, por jo si më pak i rëndësishme, dua të ndalem në një tjetër hapësirë të kujtesës për të cilën Ministria e Kulturës ka punuar në këto vitet e fundit, që është muzeu i burgut të Spaçit. Muzeu i burgut të Spaçit është një nismë që Ministria e Kulturës e ka filluar edhe këtë herë me donatorët, në bashkëveprim me *Cultural Heritage Without Borders* të qeverisë suedeze. Kemi filluar punën dhe përfundon në dhjetor të këtij viti plani i menaxhimit për burgun e Spaçit, si një vend i kujtesës. Ndërkohë, Ministria e Kulturës e ka marrë në mbrojtje duke i dhënë titullin e veçantë muzeut, hapësirës, por për vitin 2024 kemi akorduar jo vetëm buxhetin për hartimin e projektit të këtij muzeu, të këtij vendi të ri të kujtesës, por edhe të implementimit të tij, që lidhet me vënien në siguri të 7 godinave dhe fillimin e hapjes për publikun të kësaj hapësire. Besoj se kjo tregon qartë punën e bërë gjatë këtyre viteve. Më duhet të ndalem për të treguar ecurinë e tyre, për të kuptuar edhe çfarë parashikojmë më pas përgjatë vitit 2024.

Zbatimi në total i të gjithë projektit të Spaçit vlerësohet të shkojë pothuajse në 220 milionë lekë dhe për vitin 2024 do të fillojmë menjëherë me një buxhet të dedikuar prej 70 milionë lekësh. Pra, siç e shikoni, me sa ju shpjegova më sipër, viti 2024 do të ketë një peshë të veçantë për sa i përket fushës së muzeologjisë, që nuk do të ndalet dhe nuk do të veçohet nga pjesa e aktiviteteve artistike dhe jo vetëm nga pjesa e eventeve, por e ndërlidhjes së siteve të trashëgimisë së muzeve me komponentin artistik.

Besoj se për të gjithë ju që mund ta keni ndjekur, modeli i vilës së ish- diktatorit Enver Hoxha që tashmë Ministria e Kulturës e ka marrë për ta shfrytëzuar, për të sjellë në të

një hapësirë të re për artin, për artistët, duke e lidhur gjithmonë me diplomacinë kulturore, është shumë domethënëse për të treguar vazhden e nismave dhe të punëve që çojmë përpara. Patjetër, kjo do të jetë një qendër arti dhe dialogu. Tashmë me buxhetin e drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare ka nisur puna për restaurimin, ndërsa Ministria e Kulturës do të marrë përsipër të gjitha shpenzimet operacionale, kurse i gjithë programi artistik dhe kostoja për realizimin e projektit artistik, do të mbulohej nga fondacioni francez Art Explora.

Unë mund të vazhdoj gjatë duke folur për pjesën e aktiviteteve artistike, por dua të them shumë shkurtimisht që edhe përgjatë vitit 2024 do të vazhdojmë me buxhet të dedikuar për mbështetjen e projekteve artistike të komunitetit, të skenës së pavarura dhe për të dytin vit do të vazhdojmë mbështetjen e artizanëve. Viti 2023 ka qenë viti i parë që hapëm nismën për mbështetjen e artizanëve edhe pse shpesh artizanët kanë dritaren e tyre preferenciale, po themi, në dhomat e zjeve, por ne e pamë të udhës që t'i ndërthurnim sa më shumë me të gjitha nismat dhe projektet tona. Kemi pasur afro 40 të tillë, që kanë qenë projekte fituese dhe do të vazhdojmë edhe përgjatë vitit tjetër, sepse besojmë fort se të gjithë komponentët për të cilët flasim trashëgimia, artizanati, aktivitet artistike të lidhura me territorin, do të sjellin atë çfarë të gjithë kemi dëshiruar në gjithë këto vite. Pra, të mos kemi thjesht një turizëm me shifra, por mbi të gjitha të kemi një turizëm me shërbime, një turizëm me një identitet të fortë shqiptar, sepse vetëm në këtë lloj mënyre do të arrijmë të kemi një qëndrueshmëri si të punëve që çojmë përpara, po ashtu edhe të vetë qytetarëve, të komunitetit, që është emëruesi i përbashkët i të gjitha nismave që çojmë përpara.

Do të vazhdoja edhe më gjatë, por po e shikoj që mund të lodheni ndopak. Besoj se ju kam dhënë një përmbledhje të mirë dhe të detajuar për atë çfarë kemi çuar dhe çfarë po çojmë përpara për vitin 2024.

**Evis Kushi** – Zonja Ministre, shumë faleminderit për të gjitha shpjegimet e detajuara!

Ju falënderoj që u ndalët edhe në projektet aktuale, në të gjitha punët e realizuara për vitin 2023, sepse kështu kuptohet më qartë edhe vazhdimësia, edhe objektivat për vitin e ardhshëm. Ju e nisët fjalën tuaj me Festivalin e Gjirokastrës dhe sinqerisht unë dua t'ju përgëzoj dhe të shpreh vlerësimet, konsideratat më të larta, sepse kam qenë vetë, kam marrë pjesë në këtë festival, e kam ndjekur dhe vërtet ka qenë një sukses i padiskutueshëm. Sigurisht, ka shumë institucione që kanë dhënë kontribut, përfshirë edhe bashkitë, por punën kryesore për ta drejtuar për ta organizuar e keni bërë ju, Ministria e Kulturës. Uroj që edhe në vitet e ardhshme ky festival të vijojë me të njëjtin sukses, me të njëjtin angazhim, me të

njëjtin përkushtim, sepse është një nga krenaritë tona më të mëdha, për sa i takon kulturës shqiptare.

Ndërkohë, dua të shpreh vlerësimet edhe për kontributin që institucioni juaj ka dhënë në programin jashtë orarit mësimor të artit dhe zejeve në arsimin parauniversitar. Që në hartimin e këtij programi ju keni pasur një rol shumë të rëndësishëm, keni dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm, po ashtu edhe në zbatimin e tij. Ky është një projekt që Ministria e Arsimit dhe e Sportit në bashkëpunim me disa ministri të tjera, me institucione të tjera, përfshirë edhe institucionin tuaj, e ka nisur si program pilot në 200 shkolla, por unë uroj dhe kam besim, se, në fakt, ky është projekti, që ky program të shtrihet më tej edhe në të gjitha shkollat e tjera të arsimit parauniversitar. Vërtet që kontributi juaj ka qenë i spikatur, ka qenë shumë i rëndësishëm në mbarëvajtjen e këtij programi.

Nuk dua të zgjatem, por dua t'ia kaloj menjëherë fjalën kolegëve për pyetje apo për diskutime në lidhje me gjithçka që sapo prezantoi ministrja e Kulturës, por bazuar edhe mbi materialin që na ka ardhur para pak ditësh.

Atëherë, fjala për zotën Ndreca dhe më pas për zotën Beqiraj.

**Eduard Ndreca** – Faleminderit!

Dëgjohem?

Faleminderit, zonja Ministre, për të gjithë parashtrimin që bëtë!

Besoj se nuk ka nevojë për fjalë, puna është e jashtëzakonshme nga institucioni juaj. Besoj se i njëjti ritëm do të jetë edhe në vitin 2024, jam i bindur për këtë, madje, shumë më shumë nga sa shikojmë te buxheti që i është alokuar Ministrisë së Kulturës. Gjithsesi, secili prej nesh si deputetë të qarqeve të caktuara tërheqim nga vetja. E vlerësoj shumë punën për burgun e Spaçit dhe kthimin e burgut të Spaçit në një muze kujtese. Është një punë e jashtëzakonshme që po bëni, në fakt. Ajo që unë kërkoj, në fakt, nëse është e mundur nga Ministria e Kulturës, ritmet e punës për këtë muze të jenë më të shpejta dhe koha e implementimit të këtij projekti të jetë pak më e shkurtër, sepse është një çështje me ndikim të madh publik. Në fakt, ka një kërkesë të gjerë jo vetëm të qarkut, por të të gjithë vendit, sepse dihet që burgu i Spaçit ka qenë një vend vuajtjeje për elitën, pjesën më të rëndësishme të intelektualëve të Shqipërisë.

E dyta, që dua të kërkoj nga, ju, zonja Ministre, ka të bëjë me Urën e Zogut. E kam shtruar si çështje edhe herë të tjera në diskutimet që ne kemi pasur në komisionin tonë. Me sa di unë në prill është alokuar një fond apo është bërë një projekt për Urën e Matit, Urën e Zogut. Nuk e di deri ku ka shkuar puna, por di që në Urën e Zogut, deri në këtë moment që

flasim, nuk është bërë asnjë ndërhyrje, madje, po ju vë në dijeni se për shkak të shirave të fundit, ura ka pësuar edhe një goditje tjetër dhe është rrezik, nëse nuk ndërhyjmë shpejt, që ajo vepër e rëndësishme e trashëgimisë sonë arkitekturore, historike të mos ekzistojë pas 1 viti apo 2 vjetësh. Pra, besoj se duhet të llogaritet tek emergjencat. Gjithsesi, kjo është në formën e pyetjes dhe nëse e keni të mundur, dua të më jepni një shpjegim.

Faleminderit!

**Evis Kushi** – Atëherë, fjala për zotin Beqiraj.

I grupojmë pyetjet dhe, pastaj, fjala për ju, zonja Ministre, që t’u përgjigjeni të gjithave.

**Ismet Beqiraj** – Përshëndetje!

Dëgjesa me zonjën Elva Margariti ishte shumë shteruese, e plotë dhe bindëse. Unë do të them dy fjalë për këtë projektbuxhet, duke pasur një themel të fortë të realizmit të programit buxhetor të vitit 2023 për këto 10 muaj dhe për muajt që kanë mbetur, mendoj se është një bazë e fuqishme edhe për vitin 2024. Sikurse u prezantuan nga zonja Margariti, objektivat në të tria shtyllat e sektorit të këtij institucioni, qoftë në rritjen e pagave të punonjësve të aparatit të Ministrisë së Kulturës, qoftë për trashëgiminë dhe muzetë, qoftë për artin dhe kulturën, jo vetëm që janë realizuar, por paraqitja e projektbuxhetit të ri është tepër optimiste. Ajo që tërheq vëmendjen është që “pjesa e luanit” që merr në këtë buxhet sektori i trashëgimisë dhe muzetë, krahasuar me vitin 2023, ka një rritje me 21%. Pra, sikurse është shprehur edhe në program, mbi 2,2 miliardë lekë rinj, një vlerë shumë e konsiderueshme. Sigurisht, edhe projektet që paraqiti ministrja janë shumë shpresëdhënëse, pasi krijojnë një komfort tepër bashkëkohor dhe modern, pasi kultura, trashëgimia, muzetë, arti i shërbejnë edhe ofertës së madhe turistike. Është një element plus, e parë dhe e përkthyer edhe nga numri i madh i vizitorëve që ka pasur vendi, por edhe për objektivat që janë vendosur për vitin buxhetor 2024.

Sigurisht, edhe unë, sikurse dhe kolegu Ndreca, që e falënderoj, dua të them se ndihem krenar për një buxhet të tillë, për atë që është realizuar dhe atë që presim, që kemi në projekte për të realizuar.

Edhe unë do të bëj disa pyetje, sepse e tha kolegu, por do ta them edhe unë, që “tërheq kërraba” nga zona që përfaqësojmë. Nuk është faji im, po e them si me shaka, që kam lindur dhe jam rritur në një trevë shumë të rëndësishme të Shqipërisë, siç është Mallakastra, e cila në truallin e saj mban edhe themelet e qytetërimit të lashtë ilir të Bylisit. Duke parë investimet e planifikuara dhe të parashikuara, që mendohet të thithen edhe nga institucionet e

huaja me programin “Trashëgimia dhe Muzetë” për planifikimin e objekteve me shpenzime kapitale me financim të huaj, sikurse e thashë, dua të kujtoj, nuk e di nëse është harruar apo jo, apo nuk ka filluar, një marrëveshje, që besoj se zonja Margariti e gjeti kur erdhi në krye të institucionit të kulturës në shtator të vitit 2018, për planin e menaxhimit të parkut arkeologjik të Bylisit me vlerë 6 milionë euro, fond i Bashkimit European, të deklaruar nga ambasadori Soreca.

Bashkëpatriotët e mi mallakastriotë thonë me të drejtë me shpoti: iku dhe erdhi ambasadori Soreca, përsëri ky projekt ka mbetur në klasë. As këtë vjeshtë buxhetore nuk e kaloi klasën.

Unë do të bëj dy pyetje për këtë projekt. Pse nuk është përfshirë projekti i menaxhimit të parkut arkeologjik të Bylisit? Çfarë po bëhet me këtë projekt, sepse vlera e tij është 6 milionë euro? Vonesat në zbatimin e këtij projekti rrezikojnë që BE-ja t’i anulojë këto fonde? Prandaj, dua t’i them ministres se do të ishte mirë që të kishte filluar edhe ky projekt.

Një nga gjërat që unë kam kërkuar me forcë në buxhetet e tjera, ka qenë bërja e infrastrukturës, ndaj sot dua të them se rruga autostradë – qendër Hekal - Bylis ka përfunduar dhe pritet inaugurimi i saj. Ky është një lajm i mirë jo vetëm për Mallakastrën, por është një lajm i mirë për të gjithë vizitorët, turistë dhe banorë të vendit tonë, që të shkojnë ta vizitojnë lehtësisht këtë qendër të lashtë, antike, të qytetërimit ilir, me të cilën ne mbrojmë gjenezën tonë dhe tregojmë se kemi qenë një popull jo vetëm me shpatë dhe pushkë në dorë, por edhe me kulturë, penë dhe mendje. E kemi këtë qytetërim të lashtë.

Ndaj, unë kam një vlerësim dhe falenderim për këtë projekt që ka bërë qeveria shqiptare, ama mbetja në klasë, siç e thashë, e projektit që tashmë ka 5 vjet që është deklaruar nga Bashkimi European është detyrë e Ministrisë së Kulturës ta zgjidhë përfundimisht.

E dyta, në këtë projekt nuk pashë mbështetje dhe incentivim për aktivitete që lidhen me dukuritë jomateriale të trashëgimisë kulturore, si folklori. Për shembull, u zhvillua festivali i njëmbëdhjetë “Bylis Polifonia”, ku morën pjesë mbi 28 grupe nga e gjithë Shqipëria, nga trojet shqiptare, nga mërgata, të cilat promovuan këtë art të vyer jomaterial, me të cilin vendi ynë krenohet, siç është polifonia labe, që ka marrë edhe mbrojtje nga UNESCO. Nuk shikoj të ketë mbështetje për këto grupe, këto asamble, këta organizatorë, të cilët janë heronj, se, tek e fundit, promovojnë vlerat dhe kulturën e kombit shqiptar.

E dyta, janë një konfort plus shpirtëror edhe për turizmin. Ndaj, sugjeroj që jo vetëm thjesht t’i orientojmë në aplikimin për projekte me fonde, se këtë gjë ata e dinë dhe po e bëjnë shumë mirë, por edhe t’i mbështesim dhe nxisim me fonde buxhetore.

Faleminderit!

**Evis Kushi** – Zonja Ministre, fjala për ju.

**Elva Margariti** – Shumë faleminderit!

Dua të falënderoj shumë deputetët që morën fjalën dhe shtruan kërkesat e tyre, sepse edhe më shumë kemi për të treguar!

Për sa i përket projektit të Spaçit, që deputeti Ndreca e vendosi në dukje, siç e thashë, së pari duhet të miratojmë planin e menaxhimit, që u hap rrugën më pas projekteve të detajuara, që është një detyrim ligjor i kornizës së ligjit të trashëgimisë.

Po ashtu, këtë vit kemi akorduar një fond të veçantë për mbështetjen e dokumentarëve dhe dokumentimin e historive, që është një tjetër pjesë e mirë që do të na shërbejë më pas në vendosjen në dispozicion të muzeut ose vendit të kujtesës, dhe gjatë vitit tjetër fillojmë pjesën e projektit. Pra, edhe unë uroj që studiot dhe profesionistët që do të ndërveprojnë me ministrinë për hartimin e këtij projekti t'u përgjigjen po-ve tona. Ne e kemi parashikuar më pak se gjashtë muaj kohë për hartimin e projektit dhe prandaj kemi parashikuar edhe buxhet për fillimin e implementimit të tij. Pra, ne parashikojmë që viti tjetër të na gjejë si me projektin e përfunduar, ashtu edhe me fillimin e implementimit të projektit.

Gjithmonë Ministria e Kulturës fillon duke bërë planifikimin e nismave të reja duke marrë për bazë një pyetje kryesore: A është kjo një nismë kombëtare? A lidhet kjo me elemente të të gjithë territorit, të identitetit? Spaçi është një prej këtyre, siç është në zonën tuaj, që unë nuk e përmenda gjatë prezantimit, projekti “Gjurmët Fishtiane”, që e kemi nisur në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare e Planifikimit të Territorit në kuadër të 100 fshatrave, por, mbi të gjitha, e kemi nisur për figurën kombëtare të Gjergj Fishtës.

Projekti “Gjurmët Fishtiane” tashmë është në fazën e implementit të investimit. Rreth 120 milionë lekë janë të dedikuara përgjatë gjithë rrugëtimit të jetës së tij. Pra, nuk do të jetë vetëm me një ndalesë, por me disa ndalesa. Memoriali i Fishtës në vendlindjen e tij tashmë ka filluar të marrë formë. Po ashtu, edhe banesa ku ai ka jetuar për pak kohë, të cilën ju e mbani mend që e restauruam dhe e risollëm në jetë, tashmë ka një projekt të dedikuar muzealizimi.

Po-të tona për sa i përket finalizimit shpeshherë ndeshim pengesa jo të vogla, që, siç ju e dini shumë mirë, lidhen herë me pronën private e herë me problematika që mund të ketë terreni përgjatë implementimit. Megjithatë, jemi shumë krenarë që për projektin “Gjurmët Fishtiane” kemi arritur të gjejmë një sinergji dhe koordinim shumë të mirë midis palëve. Nuk e kam cituar në prezantimin tim, por është një tjetër projekt me donatorë.

Për sa i përket Urës së Zogut, është e vërtetë që kemi hartuar një projekt në bazë të Paktit për Universitetin dhe jemi në monitorim të vazhdueshëm. Nuk na rezulton që në reshjet e fundit kjo urë të ketë pasur goditje madhore, megjithatë ky nuk është një justifikim. Ne kemi hapur disa herë thirrjen drejtuar kompanive për implementimin e projektit. Është një projekt ambicioz. Përtej faktit që është një monument kulture, mbi të gjitha është një vepër arti, një vepër inxhinierike komplekse. Projekti që ne kemi hartuar së bashku me profesionistët, inxhinierët, kryesisht të Fakultetit të Inxhinierisë, është hapi i parë për emergjencën e ruajtjes sidomos të njëres prej këmbëve që është më në rrezik. Unë uroj që brenda fundit të vitit të kemi sukses me implementimin e atij projekti, që tashmë varet edhe nga mirësia jo vetëm e ministrisë, që ndjek nga afër procesin, por edhe e të gjithë aktorëve. Uroj që kjo të shërbejë edhe si një thirrje që disa kompani të bëhen bashkë dhe ta pranojmë këtë sfidë, që shpeshherë na ngel mbi supë, por është një sfidë e përbashkët e një komuniteti të gjerë. Kështu që, unë ju falenderoj që ma drejtuat si pyetje!

Për të vazhduar me pyetjet e deputetit Beqiraj, siç e thatë edhe ju, është e vërtetë që e kemi shtuar fondin për sa u përket muzeve. Unë i listova përgjithësisht projektet që lidhen me fushën muzeale. Patjetër, të gjithë e kuptojmë se Muzeu Historik Kombëtar ka një peshë tejet të madhe. Domethënë, flasim për një investim gati 26 milionë euro, ku peshën më të madhe do të duhet ta mbajë qeveria shqiptare, edhe pse është një projekt me donatorë.

Jo pak herë ne kemi pasur edhe ndërveprime totalisht me donatorët, siç është rasti i projektit të Bankës Botërore për Apoloninë, që po implementohet nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Projektin e Bylisit nuk e keni gjetur në relacionin tim, sepse është një projekt totalisht me donatorë dhe si i tillë nuk mund të programojmë buxhete në programin tonë.

Është e vërtetë që me fillimin e detyrës unë gjeta një tentativë për marrëveshje, jo një marrëveshje; gjeta një diskutim midis palëve nëse Bylisi do të ishte apo jo pjesë e një mbështetje nga delegacioni evropian me një shifër prej afro 6 milionë eurosh. Kështu që, në vitin tim të parë si ministre kam konkretizuar marrëveshjen, kam bërë të mundur që kjo marrëveshje të firmosej midis qeverisë shqiptare dhe delegacionit evropian. Më pas delegacioni evropian ka kontraktuar Agjencinë Italiane për Zhvillim, që është agjencia ekzekutuese e fondit evropian. Ne kemi bërë një takim të dedikuar jo më larg se javën që shkoi. Afati kohor i tyre për implementimin e të gjithë projektit është fundi i vitit 2026.

Gjithashtu, është e vërtetë se qeveria shqiptare me një mbështetje me fonde europiane ka ndërtuar aksin rrugor autostradë - Bylis. Në një farë mënyre ky është një tjetër element shumë domethënës i punëve të bëra nga qeveria apo institucionet përreth qeverisë shqiptare.

Megjithatë, është një projekt kompleks, ashtu siç janë shpeshherë projektet që lidhen me trashëgiminë kulturore, në këtë rast, me aspekte më të forta drejt arkeologjisë. Afati kohor i tyre për përfundimin e projektit të parë është janari i vitit 2024 dhe në maj të vitit 2024 do të nisim me fillimin e ekzekutimit të fazave të tjera, duke vazhduar, siç thashë, me skadencë që do të dakordësohen në mbledhjen e radhës në janar të vitit 2024.

Patjetër që e ndjekim nga afër, por, siç e thashë, ne nuk jemi hartuesit, por përfituesit e këtij projekti, si dhe kemi mbështetjen e donatorëve dhe partnerëve të huaj për çuarjen përpara të këtij projekti. Kjo është arsyeja pse nuk është përfshirë përsëri në vitin 2024.

Kam një falënderim shumë të madh për sa i përket aspektit të dukurive jomateriale. Mua m'u duk e tepërt që të thosha atë pjesë që e kisha nënvizuar në fjalën time. Besoj se kemi bërë jo pak për sa u përket dukurive jomateriale. Mjafton të kthejmë kohën pas në vitin që shkoi, si në këtë periudhë, kur dihebërja e Xhubletës u pranua në UNESCO si dukuri në mbrojtje nga i gjithë njerëzimi.

Këtë vit po bëhemi gati për të kaluar fazat e miratimit të një tjetër dosjeje, kësaj radhe e çuar si një dosje e përbashkët e disa vendeve, të një dukurie të përbashkët, siç është shtegtimi i bagëtive ose transhumanca. Ne besojmë fort se kjo dukuri do të lidhet shumë mirë me të gjitha elementet mbështetëse të qeverisë shqiptare në agroturizëm apo zhvillimet që ka pasur në shumë zona malore ose në brendësi të territorit.

Gjithashtu, kemi përfunduar përgatitjen e dosjes “K’cimi i Tropojës”, që ka shkuar në UNESCO-s dhe po ndjek të gjithë *iterin* e saj, si dhe dosjen mbi Eposin e Kreshnikëve.

Jemi në përfundim të dosjes së Marubit, si dukuri e kujtesës së gjithë botës. Mbështetjen e trashëgimisë jomateriale dhe kthimin e tyre në një lloj dinjiteti jo vetëm *celebrativ*, por, mbi të gjitha, një dinjiteti që lidhet drejtpërdrejt edhe me ekonominë e vetë bartësve, e kemi bërë përgjatë një viti përgatitje për festivalin e Gjirokastrës. Grupet që ju thatë janë mbështetur nga Ministria e Kulturës me fonde të posaçme për ruajtjen e kostumeve, për rigjallërimin e aktiviteteve përgjatë vitit, për të sjellë pastaj seleksionimin e tyre për javën e madhe të festivalit mbarëkombëtar.

Siç e citova, nëpërmjet mbështetjes së artizanëve nga Ministria e Kulturës u kemi dhënë mundësi jo pak herë edhe atyre grave, të cilat nëpërmjet zejeve dhe tezgjahut kanë arritur të sjellin mbështetje në këto festivale.

Ajo çfarë ndoshta duhet ta kisha cituar, sepse ka buxhet të dedikuar për vitin 2024, është që në vazhden e festivalit të Gjirokastrës për vitin 2024 kemi alokuar 80 milionë lekë për fillimin e festivalit “Folk Fest”. Do të jetë një festival me tetë ndalesa përgjatë gjithë vitit



2024, që do të prekë të gjithë Shqipërinë nga Veriu në Jug. Do ta çelim këtë nismë të re të Ministrisë së Kulturës më 28 nëntor në koncertin e madh festiv që do të bëhet në Sheshin Skënderbej për hapjen e kësaj nisme të re. Do të kemi tetë ndalesa dhe takime të rëndësishme përgjatë gjithë territorit, ku patjetër puna do të vazhdojë ashtu siç bëmë edhe përgjatë festivalit.

Unë ju falënderoj shumë, sepse më rishtuat elemente që nuk i kisha vënë në dukje gjatë relacionit!

**Evis Kushi** - Faleminderit, zonja Ministre!

Fjalën e ka kërkuar zonja Lindita Buxheli.

**Lindita Buxheli** – Faleminderit, zonja Kushi!

E falënderoj ministren Margariti për paraqitjen që i bëri projektbuxhetit të Ministrisë së Kulturës!

Doja të ngrija një problem në lidhje me Manastirin e Ardenicës, që, siç dihet, është ndërtimi religjioz më i madh në zonën e Myzeqesë dhe një vepër monumentale që daton rreth vitit 1282. Bëhet fjalë për çarjen e murit në zonën jugore të këtij manastiri. Unë mendoj se ndoshta mund të bëhet e mundur që me shpenzimet operative të vitit 2024 të bëhet ndërhyrja urgjente nëpërmjet shtyllave mbajtëse, për të mos arritur në rrënimin e pjesës jugore të manastirit. Ndërkohë, do të thosha që Manastiri i Ardenicës prej disa vitesh është shndërruar në një zonë ku mbahet panairi i të gjitha prodhimeve bujqësore blegtorale të të gjithë zonës përreth. Numri i madh i vizitorëve, rreth 40 mijë të tillë në një vit, tregon rëndësinë e madhe të Manastirit të Ardenicës. Ndërkohë, gojëdhënat, siç e dimë të gjithë, e identifikojnë atë si vendi ku Skënderbeu vuri kurorë.

Kështu që, zonja Ministre, do t'ju kërkoja ta shikonit në buxhet, me shpenzimet operative të vitit 2024, ndërhyrjen sa më shpejt dhe mbajtjen të paktën në këtë gjendje ku është, sepse për shkak të erozionit, me sa di, viti '90 është viti i fundit kur është bërë rikonstruksioni i fundit i Manastirit të Ardenicës, është degraduar pjesa që përmenda më sipër.

Faleminderit!

**Evis Kushi** – Faleminderit, zonja Buxheli!

Zonja Ministre, a keni diçka për të shtuar?

Fjala për ju.

**Elva Margariti** – Po, është shumë e drejtë. Ne e kemi ndjekur nga afër me Institutin e Monumenteve çështjen e Manastirit të Ardenicës. Jemi në fazën e monitorimit dhe hartimit të

projektit. Kemi bërë një studim paraprak. Në fakt, ka një vlerë jo të lartë; është afro 5 milionë lekë të rinj ajo që duhet të ishte faza e parë emergjente, flasim gjithmonë për vënien në siguri.

Në buxhetin e vitit 2024 kemi pasur një listë të gjatë të kërkesave shtesë, për hir të së vërtetës, drejtuar Ministrisë së Financave. Siç e thashë, me Institutin e Monumenteve ndjekim një listë prioritare. Jo të gjitha na miratohen, në bazë edhe të buxheteve dhe tavaneve në dispozicion, por duke qenë se është një vlerë jo e lartë ne jemi futur në negociata me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, i cili ka projekte me donatorë jo larg saj për të bërë një rialokim të brendshëm të fondeve të atij projekti dhe për të shtuar në këtë ndërhyrje. Përndryshe, nëse ky variant nuk do të na miratohet, kjo nuk varet nga ne, por nga procedurat burokrate shpeshherë të programeve me donatorë. Ne do ta çojmë kërkesën përpara në Komitetin e Emergjencave Civile, siç kemi bërë edhe herë të tjera, nëse do të kemi miratimin e tyre. Pra, ka një vlerësim tjetër, që e lidh më pas monumentin me emergjencën civile. Këta janë dy skenarët ku po punojmë, për sa kohë nuk e kemi mundësinë paraprakisht për ta çuar përpara.

Siç e thatë edhe ju, unë do të isha shumë e dëshiruar nëse edhe kërkesat që do të arrijmë të mbledhim gjatë komisioneve do të arrijmë t'i reflektojmë më pas në ndryshime shpeshherë shumë të vogla të projektbuxhetit të propozuar. Megjithatë, siç e thashë, po ecim me dy skenarë të tjerë dhe instituti është duke hartuar projektin e emergjencës.

**Evis Kushi** – Shumë faleminderit, zonja Ministre!

Nuk e di nëse keni pyetje të tjera.

Zoti Spaho e ka kërkuar fjalën.

**Florenc Spaho** – Faleminderit, zonja drejtues e komisionit!

Faleminderit, zonja Ministre, për të gjithë shpjegimin shterues!

Në fakt, sa herë flasim për artin dhe për kulturën, buxhetet nuk mjaftojnë. Asnjëherë nuk është mjaftueshëm të investohet dhe të ketë një buxhet të kufizuar për sa i përket kulturës, por, në fakt, ju prej disa vitesh, me buxhetet që ju janë vënë në dispozicion, keni bërë më të mirën e mundshme, sepse keni arritur ta transmetoni kulturën shqiptare jo vetëm brenda territorit shqiptar, por edhe jashtë, si në vendet e rajonit, ashtu edhe të Bashkimit European.

Në fakt, disa pyetje u konsumuan edhe nga kolegët tanë të komisionit. Unë doja të vija në pah mbështetjen për artistët e rinj, sidomos për artistët *freelancer*. Duke qenë se ne jetojmë në një botë në të cilën teknologjia, digjitalizimi, rrjetet sociale kanë arritur maksimumin e vet, a keni ju një plan, zonja Ministre, për sa u përket artistëve të rinj, të cilët mund të mos jenë në universitete, por mund të jenë edhe në shkollat e mesme, për të bërë disa

konkurse, ku mund të promovohen artistë të cilët me gjithë mend mund të japin nga vetja e tyre, që të mund të kenë edhe një kohë të dedikuar në televizione, siç kanë qenë dikur, para shumë vitesh, “Maratona” apo “Rinfest”, ku promovoheshin artistë në fusha të ndryshme, si: kënga, arti, aktrimi, kërcimi?

E dyta, rijetëzimi i kalasë së Elbasanit, që është kalaja e vetnija në Shqipëri në një zonë fushore, e cila përmban një kulturë shumë të madhe dhe ndoshta ka për të promovuar edhe pjesën e bashkëjetesës fetare, sepse brenda saj gjenden kisha ortodokse, kisha katolike, xhamia dhe sinagoga hebraike. Pra, mund të jetë diçka e shtuar, që ju mund ta promovoni ndoshta edhe me ndonjë buxhet të dedikuar.

Faleminderit, zonja Ministre!

**Evis Kushi** – Zonja Ministre, fjala për ju.

**Elva Margariti** - Shumë faleminderit!

Siç e thashë, çdo vit ka një buxhet të dedikuar për artistët e rinj, të cilët mbështeten jo vetëm nga projektet që ne i quajmë “projekte me thirrje”, ku ka disa shtylla prioritare; njëra prej tyre është edhe mbështetja nëpërmjet digjitalizimit të trashëgimisë kulturore, ashtu siç është edhe artizanati, se nuk e lidhim artizanatin thjesht me një moshë më të madhe. Patjetër që të rinjtë që kanë sjellë forma të reja të artizanatit, të inspiruar nga tradita, janë mbështetur nga Ministria e Kulturës, por, si gjithmonë, edhe në artin në hapësira publike të rinjtë vazhdojnë të mbështeten. “Bienalja e Venecies” është një tjetër hapësirë e dedikuar, ku artistët mbështeten nëpërmjet fondeve të ministrisë. Në fushën e librit kemi thirrje të vazhdueshme nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit për krijimtarinë e të rinjve ose për përkthimin e librave, të cilat kanë fonde të dedikuara.

Unë do të ndalesha te nismat që lidhen me “Fondin e teatrit për të rinjtë”, që drejtohet nga Teatri Eksperimental. Kemi pasur një numër shumë të lartë aplikuesish dhe kemi afro 10 teatro, ku marrin pjesë të rinj nën 35 vjeç. Ky është kriteri i parë që vendosim për mbështetjen e kësaj nisme. I dyti është që shfaqja të zhvillohet në një nga teatrot e rretheve dhe jo vetëm në Tiranë. Pra, jemi duke ndërthurur disa politika të ndryshme të ministrisë, ashtu siç kemi fondin e krijimtarisë në dramaturgji dhe në muzikë, fondin e kompozitorëve të rinj, fondin “Çesk Zadeja”, që zhvillohet pranë Teatrit Kombëtar dhe numri i artistëve të rinj, të cilët po i bashkohen Tetarit Kombëtar të Operës dhe Baletit, është gjithmonë një trend në rritje.

Ndërkohë, ministria është duke përgatitur një draftligj për trajtimin e veçantë të artistëve, për t’u përballur, po themi, me një ngërç burokratik për artistët tanë edhe në mosha

të mëdha, që nuk u krijon atyre mundësi për të performuar, si rasti i balerinëve. Kjo sjell jo vetëm mbështetjen ekonomike të artistëve që i largohen trupës kombëtare, por mundësinë e hapjes së vendeve të reja për të rinjtë, për të performuar në institucionet tona kombëtare. Siç e thashë edhe në fillim të fjalës, janë institucione tashmë me paga jo vetëm dinjitoze, por tejet konkurruese në tregun rajonal. Pra, janë nisma të ndryshme, siç e thashë: digjitalizimi, artizanati, libri, krijimtaria e teatrove dhe punësimi sidomos i të rinjve.

**Evis Kushi** – Meqenëse nuk kemi pyetje të tjera, ju falënderoj shumë, zonja Ministre, për të gjitha shpjegimet tuaja dhe ju uroj shumë suksese për projektet ekzistuese, por edhe për të gjitha iniciativat, projektet e reja që do të mbështeten me buxhetin e vitit 2024!

Të nderuar kolegë, shumë faleminderit të gjithëve!

Ju njoftoj se mbledhja e radhës do të zhvillohet nesër, në orën 15:00.

Faleminderit, zonja Ministre!

Faleminderit, kolegë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**